

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 KORRIK 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

VENDI KU VDIQ EMIGRANTI SHQIPTAR, BRITANIA MBYLL ANIJEN FAMËKEQE, BIBBY STOCKHOLM



PETRIT KUÇANA
KUSH GUXON
TË FLASË PËR
AEROPORTIN
E KUKËSIT?



DUAJE SHQIPËRINË EDHE
KUR ATË E DREJTOJNË
HAJDUTËT E 'RILINDJES'

KIM MEHMETI



RAPORTI: SI AGJENTURAT
E HUAJA SABOTUAN
TURIZMIN

LUTFI DERVISHI



ARBEN MANAJ

KAMPE NE
SHQIPERI, PER AZIL
DHE HEQJE VIZASH
BRITANIKE

MBRËMË U VRA
NJË KAMARIER!


GJERGJ META

STINË E
JOMËRZITSHME
PËR NË OLIMP

VETON SURROI

MAL BERISHA SJELL NJË BOTIM
SUI GENERIS PËR OPUSIN E
VEPRËS SË SIR NOEL MALCOLM
PËR SHQIPTARËT

BESNIK MUSTAJ



POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929

**PETRIT KUÇANA**

As që mund mendohet se do të gjendet lehtë, jo faji por shakaku i kyçjes së aeroportit të Kukësit.

Në këto ditë përvëluese, kur mërgata është nisur për të kaluar pushimet në mëmëdhe, pikërisht në këtë kohë, ai që u trumpetua si sukses i padiskutueshëm i qeverisë shqiptare, Aeroporti i Kukësit, i

KUSH GUXON TË FLASË PËR AEROPORTIN E KUKËSIT?

është vënë kyçi.

Flatrat e Veriut janë ngrirë... E gjithçka mbulohet me tisin e heshtjes, sikur asgjë të mos ketë ndodhur, sikur ashtu padashje u bë gabim që u hap, aeroporti i qarkut më të varfër të republikës.

'Flatrat e Veriut' janë ngrirë dhe si një makth që pret përfundojë, e lënë andej, pa ndonjë vëmendje, pa ndonjë interes, (si fëmijë të gjetur), por kurrësi si mundësi për të gjithë qarqet e veriut dhe jo vetëm.

Ngjan kaq e thjeshtë pyetja përse, apo kërkesa për ndonjë sqarim, jo vetëm për votuesit e bindur të paimunizuar me propagandën gjithëpërfshirëse qeveritare, por për qytetarët e thjeshtë, qoftë edhe për turistët.



Askush nuk guxon, jo të japë përgjigje, por as të përmendë se ka qenë, se ka ekzistuar një aeroporti i tillë, se u bë kaq shumë propagandë s'vetë 'i madhi', shkoi atje, si mesia, shpëtimtari që do të sillte siç tha në atë kohë. 'çunat e Londrës' në Kukës. Po vetëm pak kohë më pas, po ngjan se diçka ka shkuar keq, se ca llogari janë bërë gabim dhe se zgjidhja paskërka qenë, venia e

kyçit aeroportit të vetëm alternativ të vendit.

'Flatrat e Veriut' i ngrinë në këtë vapë përvëluese, duke kërkuar më çdo kusht mbulimin e padepërtueshëm më tisin e heshtjes. Askush nuk guxon që të pyesë qoftë edhe për një përgjigje të thjeshtë, të pafajshme, konkrete, që të mund të lehtësojnë peshën e pyetjes 'përse'. Shumëkush mund të justifikohet me

shprehjen e famshme të kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, për 'Shqipërinë e Kastriotit dhe jo të Kastriotit'. Të tjerët besojnë se do të duhej me patjetër që aeroporti i Kukësit, të ishte një motor i vërtetë zhvillimi jo vetëm për qarqet e veriut, më të varfërat në vend, por motor i fuqishëm për zhvillimin e turizmit në vend.

Kur më shumë se tani është dashur ai aeroport?

A do të guxojë kush, qoftë shtetar apo pastronazhist që të sqarojë pse-në?

Gjasat janë se tisi i heshtjes, do të vazhdojë të mbulojë 'Flatrat e Veriut' edhe për shumë e shumë kohë, ndërkohë që edhe një tra tjetër është vënë mbi qafën e banorëve më të varfër të republikës...



AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARET NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER **SPONSORSHIP LICENSE**

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Samiti i liderave evropian ne Oksford ne pallatin Blenheim, vendlindjen e udheheqesit britanik te kohes se Luftes se Dyte Boterore, Uinston Curcill, pati ne qender te takimeve dhe diskutimeve ceshtjet e sigurise dhe migracionit, ku kjo e fundit nuk u cilesuar me "sfide", sesa "krize". Ne takimin per ceshtjen e emigracionit, mediat raportojne se Kryeministri i ri laburist Sir Keir Starmer ka takuar ne margjinat e tij gjate nje bisede joformale, ka folur me kryeministrin Edi Rama, per protokollin e nenshkruar se fundmi mes Italise dhe Shqiperise per hapjen e qendrave te refugjateve ne territorin shqiptar. Sipas nje zedhenesi te Downing Street te cilin e citojne

EMIGRANTËT, RAMA KËSHILLON STARMER. SAMITI I KOMITETIT POLITIK TË BE VJEN NË SHQIPËRI

mediat, dy liderat kene folur per ceshtjet e sigurise, perfshi edhe imigracionin ne vecanti, zgjedhjet inovative si ajo e partneritetit Itali-Shqiperi.

Sipas mediave britanike, Starmer dhe Rama" kane rene dakort te vazhdojne te te forcojne marredheniet mes dy vendeve tona". Media britanike i ka kushtuar vemendje veshjes sportive te kryeministri Rama me atlete ne kete takim ndryshe nga te gjitha liderat e tjere ne kete Samit me te madhin ne territorin britanik te kaq shume udheheqesve evropian sidomos pas Brexitit. Kryeministri Rama eshte takuar bashke me kryeministren italiane Meloni edhe me Mbretin Charls.

Padyshim Britania ka mjaft interes ne bashkepunimin evropian per ceshtjet e emigracionit, dhe padyshim marreveshja mes



Shqiperise dhe Italise shihet me interes si e ketille.

Por konkretisht se cfare kane diskutuar dhe deri ku kane shkuar bisedimet mes kryeministrit britanik

dhe atij shqiptar per nga vete natyra sekretive e ketyre takimeve, mбетет ende e paqarte per publikun. Ne konferencen per shtyp pas takimit kryeministri britanik permendi marreveshjen mes Italise dhe Shqiperise e cila eshte me interes per britnaiket, por tha se ne duam ta luftojme emigracionin ne origjine dhe marreveshjet pa specifikura se per cfare marreveshje konkretisht vijne me pas dhe nuk pranoje te flas se cfare ka biseduar me lider te ndryshem evropian.

Gjithesesi, per ceshtjen e qendrave te emigranteve ne territorin shqiptar, kryeministri Rama me pare ka deklaruar se Shqiperia nuk do pranoje nje marreveshje te tille si ajo me Italine, per Britanine e Madhe.

Ne nje arritje diplomatike per Shqiperine, ne fund te samitit, Kryeministri britanik Sir Keir Starmer deklaroi se eshte rene dakort se samitet e Komitetit Politike Evropian, do zhvillohen ne vitin 2025 ne Shqiperi dhe Danimärke.

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

ARTE Home Furniture

NOW OPEN



%20

WITH THIS
VOUCHER



Address: 1 Aldermans Hill, London N13 4YE

0 7447 992436

 [artehomefurniture](#)

 [artehomefurniture](#)

 info@artehomefurniture.co.uk

KAMPE NE SHQIPERI, PER AZIL DHE HEQJE VIZASH BRITANIKE

ARBEN MANAJ

Qe edhe qeveria e re britanike e Sir Keir Starmer do e kete po aq pisk emigrimin ilegal sa edhe paraardhesja, dhe qe po tenton te kete idera te reja, por zorr se do jene efektive, kjo eshte e qarte edhe nga c'ka deklaroi kryeministri i ri britanik, ne vendlindjen e Curcillit, kur la te kup-tohet se eshte i hapur per idene e ngritjes se qendrave te shqyrtimit te kerkesave te emigranteve afer vendeve te tyre te origjines. E thene cope, pak a shume, njesoj si Sunak deri diku me Ruanden.

Fakti qe Britania, jo vetem se fundmi, por prej vitesh gjate sundimit te konservatoreve ka shprehur interes per hapjen e kampeve si ato te Italise ne Shqiperi, edhe per emigrantet e ardhur ne ishull, deshmon se do e donin nje gje te tille.

Rama ka refuzuar deri me sot ose dje, nese spekullohet, por vetem ai e di, dhe s'ka perse te mos prezumohet deri ne nje prononcim te ri, nese ka ndryshuar ose eshte i prirur, te ndryshoj qendrim.

Une do e shtyja te ndryshonte qendrim dhe te ishte pragmatist, sic kerkon te jete edhe Sir Keir Starmer, edhe pse mund te akuzohet si narcist transaksional.

Britaniket jane te deshperuar per nje gjetje, dhe nese Rama do ndryshonte kurs, ata do e mireprisnin krahapur, pasi do behej fjale, nder shume arsyesh, per nje vend ne territorin evropian, dy ore e gjysem nga Londra dhe jo diku ne Afrike, nente ore e kusur me avjon dhe shpenzime marremendese.

Rama mund te reset-i marredheniet ose ujdine me Londren, gje qe nuk e beri me marrevshjen me Sunak ne 2022-shin, ku bashkepunojte me kon-



servatorete per luften kunder krimet te organizuar e shume fushta te ligjzbatimit dhe beri shume mire.

Por per shqiptaret e Britanise, dhe statuset e tyre legale deshtoj, pavaresisht nese kishte mundesi apo jo, per me shume. Une besoj se kishte dhe nuk perfitoj sa presidenti Paul Kagame i Ruandes qe perfitoj afro 300 milione sterlina dhe shume te drejta qarkullimi dhe statuse ligjore per ruandezet, sepse ra dakort te priste emigrantet ne vendin e tij edhe pse asnje nuk shkoj faktikisht.

Ne rrethanet e reja, me nje kryeminister te qendres se majte laburist, thene ndryshe brenda gardhit te tij politik, kur edhe po krijon nje raport edhe personal me Starmer, si ne Oksford, dhe per keto raporte Rames i duhet hequr kapelja si tejet i zoti dhe politikan race ne kete fushe, dashamiresisht do i sugjeroja si nje shqiptar i

Britanise, shtetas britanik, qe per ata bashketdhetare te mi rrugeve te Londres, Birmingamit apo Edinburgut, apo edhe burgjeve britanike, shume syresh me te drejte ligjore, aty ku jane, edhe pse i toleroj deridiku moralisht, se keshtu u erdhi jeta, qe te negocjoje me forte per me shume te drejta per shqiptaret.

Nese Londra pritet te amnistoj 80 apo 100 mije te ardhur me gomone nga cdo cep i bote, ku ka konflikte ose trazira, por jo nga Shqiperia ne rastin tone, perse jo, ne kembim te nje qendre si ajo e Italise, qe nuk do e permbysh Shqiperine, por do e bej po aq heterogjene sa c'eshte Britania etnikisht, apo edhe Gjermania apo Italia, Rama te mos kerkoj legalizimin si fillim, te te gjitha shqiptareve qe jane rrugeve te Anglise, Uellsit e Skocise, dhe me kohe borxh nga emigracioni, qe edhe ata te sistemohen

ligjerisht ne ishull?!

Nuk do mbytet Britania nga 30 apo 40 mije shqiptare pa letra, pasi nuk do mbytet as nga 80 apo 100 mije nga keta te ardhurit keto vitet e fundit me gomone neper La Mansh, qe pritet te aministohen.

Te paktin, nese do ndodh, shumica dermues e tyre, nuk do perfundonin ne shtepite e barit dhe ne faqet e mediave dhe tabloideve anti-emigrante te Londres.

Kjo do i qetesonte dhe i orientonte keta emigrante, drejt ligjshmerise dhe ndertimit te nje jete dinjitoze dhe ligjzbatuese per keta shqiptare, shumica te rinj ne moshe, sic jane dinjitoz shumica dermues e shqiptareve qe jane me status dhe dokumnta te rregullta, aktualisht ne Britani.

Kerkesa tjeter, mese normale, dhe qe

nuk do i kushtonte asgje Britanise, por do i kursente financave britanike, por edhe burgjeve te tejmbushura dhe ne krize te ketij vendi, ku une jetoj, edhe shpenzimet ne emigracion dhe mbrojte te drejtave te tyre ligjore, qe shkojne ne miliona sterlina, nese Rama do kerkonte qe shqiptareve te hiqeshin vizat britanike dhe te udhetonin lirshem, sic bejne kudo ne zonen Shengen dhe t'u jepej e drejta e punes ne kete vend.

Kjo do ishte e mire edhe per industrine e turizmit dhe aviacionit civil, se do ikin dhe ktheheshin lirshem shqiptaret nga Britania drejt Shqiperise, ne shumicen dermuese te vitit me nga 29 sterlina bilete kthyes nga Londra ne Tirane apo Vlore neserdej.

Edhe kjo nuk do ishte barre e rende per Britanise, pasi gjysma e shqiptareve e kane leshuar ne nderkohe Shqiperine, dhe ata qe kane mbetur dhe do udhetonin drejt Britanise dhe mbrapsht, do jene, se nje qytet i vogel polak apo gjysma e ndonje kryeqyteti evropianolindor, tashme anetare e BE-se, qe vijne dhe ikin nga vendi i tyre drejt Britanise dhe kthen mbrapsht lirisht dhe rregullisht dhe jo neper ujrane e La Manshit.

Kjo do ishte nje situatë win-win per Britanise dhe Shqiperine.

Dhe une, si shumica e shqiptareve racional, do i'a falja pragmatizmin politik apo narcizmin transaksional Rames, nese ai do fitonte politikisht nga levizje te tilla per vete dhe qeverine e tij, qe i sjellin perfitime shqiptareve te Britanise dhe jo vetem, pasi do merrte hakun e vet, ne raport me lehtesimin e jetes se shqiptareve. E ne ate rast fatlum apo hipotetik, ne Londer, do e prisnin si hero, njelloj si ne Athine e Milano, sepse do i atribuohet atij personalisht dhe ekskluzivisht!

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946

VENDI KU VDIQ EMIGRANTI SHQIPTAR, BRITANIA MBYLL ANIJEN FAMËKEQE, BIBBY STOCKHOLM

Ministria e Brendshme e Britanisë së Madhe ka njoftuar se kontrata për anijen Bibby Stockholm, e cila është përdorur për të strehuar azilkërkuesit në brigjet e Dorset, nuk do të rinovohet në janar.

Anija, e cila ka qëndruar ankoruar në Portland, ka qenë një pjesë e programit për azilkërkuesit, por zgjerimi i përdorimit të saj do të kushtonte mbi 20 milionë paund në vitin e ardhshëm.

Bibby Stockholm është një anije trekateshe me kapacitet për deri në 500 burra në moshën nga 18 deri në 65 vjeç. Vendimi për të mos rinovuar kontratën është pjesë e një angazhimi të qeverisë laburiste për të rregulluar sistemin e azilit dhe për të reduktuar kostot për taksapaguesit.

Anija do të vazhdojë të strehojë azilkërkues deri në skadimin e kontratës në janar 2025. Kjo mbyllje vjen pas një debati të gjatë dhe shqetësimesh nga banorët vendas në Portland, disa prej të cilëve kundërshtuan praninë e anijes për shkak të impaktit në komunitet dhe shërbimet lokale.

Aktivistët gjithashtu kanë shprehur



shqetësimet e tyre për kushtet në të cilat jetojnë azilkërkuesit në anije, duke përmendur rastin e emigrantit shqiptar Leonard Farruku i cili u gjet i vdekur në kabinën e tij.

Leonard Farruku, 27-vjeçari shqiptar, ndërroi jetë në dhjetor të vitit të kaluar në anijen Bibby Stockholm në portin Portland, Dorset. Ai ishte në pritje të vendimit për kërkesën e tij për azil nga Zyra e Brendshme kur u zbulua se kishte fituar të drejtën për të punuar në Angli, e cila i ishte dhënë nga Home Office. Farruku kishte mbërritur në Angli një vit më parë me një varkë të vogël përmes Kanalit të Mançesterit, pas pagesës së 4,000 euro kontrabandistëve.

Dyshohet se ai e ka marrë vendimin për ti dhënë fund jetës në kabinën e tij pasi kishte shqetësime për shëndetin e tij mendor.

MAL BERISHA

RRUGA ROMAKE NË MES TË SHQIPËRISË [Për Mehmet Beun]

Shkruar nga miku më i madh i shqiparëve, koloneli anglez Aubrey Herbert
Me pseodenimin e tij Ben Kendim.
Përkthyer nga: Mal Berisha

Është një rrugë që i përshkon malet tona, si majë e një shpate,
Gjarpëron ndër pyje t' gjelbërta edhe ndër' monopate,
Vende – vende e rrënuar ku shekujt kanë lënë kujtimin,
Mbushur me gur' varresh që të sjellin dhe trishtimin.


Rruga e shtruar nga romakët zgjatet gurë përmbi gurë,
Dëgjohen fëshfërima pemësh dhe ujrat që rrjedhin në gurrë,
Ata mes maleve marshonin në mes të shkrepjeve të vetëtimës,
Tregëtinë e përjetshme romake ta bënin mes zhurmës dhe oshtëtimës.

Filipi i Madh maqedon, kaloi pranë kësaj rruge, me nxitim,
Me dyzet burra para e pesë mijë tjerë mburojë kalorsiake,
Pushtimet e tij të shpërndara si mjegulla në agim,
Në gurë romakët i gdhendnin fitoret e tyre luftarake.

Rrugën për tregëti e ndërjuan ata, betejës së tyre i printe Zoti,
Mbi kalldrëmin gur – gurë, rëndë – rëndë, shkëlmin ata qëmoti,
Malësorët trup – zhdërvjellët, këmbë – lehtë dhe sy – shigjetë,
Që trimërinë dhe shkathtësinë ua kishte falë Zoti Vetë.

Ata këndojnë tek kthesa e parë e pyllit të gjelbërt tek ai dhé,
Aty ku dikur atë rrugë e shkeli i Madhi Skënderbe!
Me shpatat që iu flakërojnë në duar, i falen perëndisë,
Tek kthesa e dytë nderojnë betejën që ua mbrojti prapun e shtëpisë.

RRUGA ROMAKE NË MES TË SHQIPËRISË



Rrugës së lashtë me mall barinjët shqiptarë këndojnë,

Kur bora zbardh malet e prrojet plot vërshojnë,
Dhe për misrin, arin dhe qelibarin që udhtarët tregëtojnë,
Ata duan që me Rrugën Romake Mbretin tonë të nderojnë.

Sa jetë janë dashur për ta shtruar atë rrugë gjarpënore?
Me copa mishi njerëzish e mbetjet e tyre kockore,
E lagur me lotët e grave në dhimbjen e tyre mëmënore?!
Rruga e Mbretit në Shqipëri tani shtrihet e vetme, sot e prore.

Le të vlojë gjaku i derdhur, dashuri të zgjojë,
Nga fjalët e Profetëve krejt vendi të ushtojë,
Mbreti vjen në Shqipëri: Ai në këtë rrugë do të kalojë,
Shkatërrimet turko – sllave, bëra rrugës do t'i rregullojë.

Shqiponjat fluturim mbrëmjes ja "prishin" qetësinë,
Ujqit që dikur gjuanin aty-pari, më nuk ulurijnë,
Ne që luftuam komandirët e arritëm lavdinë,
Besnikë trima ishim, të bardhë, si bora e maleve tona që ndrijnë.

Në shtigjet e ngushta kuajt e lodhur i shkundin ato jela,
Krismat e armëve shurdhohen prej të lumit rrjedha,
Rrëmuja e muzgut gjakun e bën të vlojë, mëngjesi e shkrin
vesën,
S'ka shpatë, stuhi as përmbytje që shqiptarin e bën të shkeli
Besën.

Ashtu siç vijnë baticat valë – valë, vjen edhe dashuria vllaznore,
Dashuria jonë e pafund: Se jemi Shqiponja Arbnore,
Jemi shqiptar që për atë Zot do t'ia dalim:
Të betuar e të lidhur dorë më dorë – deri në fitore!

Ben Kendim

LEA YPI, SHQIPTARJA E PARË QË BËHET PJESË E AKADEMISË BRITANIKE

Në historinë e Akademisë Britanike, për herë të parë një shqiptare është pranuar në radhët e saj: intelektuala dhe profesoresha Lea Ypi. Ky është një moment historik për komunitetin shqiptar dhe një arritje e rëndësishme për vetë Ypin, e cila është njohur dhe vlerësuar për punën e saj të jashtëzakonshme në shkencat humane dhe shoqërore.

Puna e femrës shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar kurorëzohet gjithmonë me vendin që ajo meriton. Është aq kënaqësi sa edhe krenari që një përfaqësim i këtij niveli të lartë e bën profilin e intelektuales shqiptare në botë një frymëzim edhe për brezat.

Akademia Britanike ka zgjedhur 86 studiuues kryesorë nga fusha të ndryshme për të qenë pjesë e Fellowship të saj këtë vit. Nga këta anëtarë të rinj, 52 u zgjodhën nga 21 universitete në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa 30 Fellows Ndërkombëtarë u zgjodhën nga universitete të tjera në botë, përfshirë SHBA-në, Kanadanë, Afrikën e Jugut, Japoninë, Kinën, Australinë, Tajvanin, Zvicrën, Gjermaninë, Italinë, Holandën, Turqinë dhe Izraelin. Gjithashtu, Akademia zgjodhi katër Anëtarë Nderi nga bota e artit, letërsisë, gazetarisë dhe filmit.

Lea Ypi është një personazh tejet i diskutuar kohët e fundit. Natyra e saj e qetë i jep një përkufizim çdo diskutimi në mënyrën

më origjinale dhe të vërtetë. Ajo ka të gjitha karakteristikat e një gruaje shqiptare me diapazon, e brumosur nga shumë kultura, duke udhëtuar në ekuilibër midis sintonive njerëzore, si në punë, me penën e saj, ashtu edhe në jetën e përditshme. Hapësirat bosh i mbush me kryeneçsinë e studiueses, por me këmbë në tokë. Është e çiltër dhe bujare në shprehjen e lirisë së veprimit dhe të mendimit, pa krijuar konflikte. Duke më besuar shpesh copëza dorëshkrimi nga libri i saj dhe duke më bërë pjesë të veprës së saj nëpërmjet diskutimeve me pikëpamje herë të njëjta dhe herë të ndryshme, u përfshiva në entuziazmin e një mendjeje të hapur, siç është edhe ajo vetë. Seç ka një veçanti stili i saj, të cilin ajo e përdor lirshëm, pa sajuar apo

ngushtuar me çdo kusht konturet e së vërtetës, ashtu siç ajo e ka përjetuar: pa paragjykim, pa drojë, pa frikë dhe me dashuri prej fëmije e të rritur tashmë. E njohur me librin i saj "Free" i karakterizuar nga timbri i lirë i shpirtit dhe dinjitetit, kur nuk ishim të lirë. Kjo është e vërteta e saj!

Lea është një docente profesore dhe teorisë politike në "London School of Economics" (LSE). Përveç librit në fjalë, i cili është botuar nga shtëpia botuese "Penguin London" e më pas në shqip nga shtëpia botuese "Dudaj" dhe është përkthyer e botuar nga një sërë shtëpish botuese në shumë shtete, ka nxjerrë edhe librat "The meaning of the partisanship" dhe "The architectonic of reason" të botuara nga Oxford University Press. Konceptin e lirisë dhe për luftën e vazhdueshme me të cilën përballet çdo ditë një grua në karrierë, të cilat ajo i njeht mirë, e ka shpërndarë gjithmonë me frymën e lirë në shumë auditore të niveleve të larta ndërkombëtare ku është mirëpritur dhe duartrokitur me onoret e merituar.

ANILA KADIJA



AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

GJERGJ META

Mendoj për mëngjesin e asaj dite, kur ai djalë ka dalë nga shtëpia duke e përcjellë zëri i s'ëmës: "Mirë ardhsh, o bir!".

Oh, ç'kob i zi! Djali nuk "erdhi" hiç mirë nga puna atë mbrëmje. Nuk erdhi fare. Ai urim i mëngjesit shkoi kot.

Ç'borxh pati?!

Kujt nuk ia çoi porosinë në kohë?!

Kush u mërzi se i shkoi kafja e keqe?!

Një jetë e re u këput - gjë për të cilën do të flitet disa ditë - si pasojë anësore e një krimi mafioz, siç paraqesin në mënyre konfuze dhe joprofesionale mediumet virtuale. Lajmi ndryshohet çdo minutë, ama kamerieri qëndron ende i shtrirë, pasi ai po çonte porosinë e tij të fundit, kur u përshkua nga plumbat. Për të nuk ndryshon më asgjë. Në histori do të mbeten emra të tjerë, por jo ai kamerier anonim nga Memaliaj.

Çdo herë që shoh kameriere që shërbejnë nëpër bare e restorante, mendoj për lodhjen dhe guximin që ata kanë, si edhe për familjet e tyre. Ata punojnë për pak qindarka që mund të nxjerrin nga ndonjë bakshish.

I përfytyroj duke dëgjuar tekat e klientëve, të cilët sigurisht që pagua-

MBRËMË U VRA NJË KAMARIER!



jnë, por shpesh janë të lodhshëm. Me siguri kanë edhe ata hallet e tyre.

Mbrëmë u vra një kamerier! Na duhen vajtimore. Jo për kamerierin. Atë e qan e ëma. Na duhen vajtimore për mjerimin e një shoqërie që vret bijtë e vet. Hadi i një sistemi kriminal po na e heq dheun nën këmbë. Një popull që edhe kur nuk është nën krismat e kallashit, dergjet nën thundrën e më të fortit - jo gjithmonë nën zhurmën e thatë të armëve, por vazhdimisht nën peshën e pushtetit të parasë dhe të pasurisë - është një popull me blana të hapura që nuk shërohen kurrë.

Një tjetër kamerier, në ekranin e televizorit të lokalit ku punon, i cili sa ndizet çohet gjithmonë te një kanal lajmsh, shikon se një "koleg" i tij është vrarë gjatë orarit të punës, por ishte thjesht viktimë. Nuk ishte shënjestra. Nuk ishte pjesë e sagës. Përhumbet disa çaste, por lajmi kalon shpejt dhe folësja e lajmeve thotë: "Mazhoranca dhe opozita bashkuan votat për krijimin e komisionit antikorrupsion". Kamerieri e ka ditur gjithmonë se diçka i bashkon ata...

Ndërkohë, dëgjon një zë prej tavolinës anash: "Djali, na sill një shishe uji me temperaturë ambienti. Pak shpejt!"

ALFRED LELA

Në fillim duhet anashkaluar miti që një pjesë e medias, komentariatit politik dhe politikës vetë ka ndërtuar për SPAK si një organizatë me shtatën e drejtësisë dhe të pagabueshmërisë. Janë disa prova të mëdha që e kundërshtojnë këtë. SPAK nuk duhet të 'shenjtërohet' si lopa në Indi, kafshë që bredh rrugëve me më pak kufizime se njerëzit dhe makinat. Nëse lopët në Indi pengojnë pamjen dhe qarkullimin, një vështrim i SPAK si 'i paqortueshmi', mjegullon logjikën.

Kështuqë, le të jetë SPAK, si çdo institucion tjetër i kritikueshëm dhe të shihet si i gabueshëm.

Pjesë e ndërtimit të mitit të SPAK, ndër më kryesorët, kanë qenë sondazhet televizive ku Prokuroria e Posaçme 'shkëlqen' me rreth 70 përqind të besimit të shqiptarëve.

Ndërkohë që mund të jetë kështu, pyetja e parë që duhet bërë është: pse e beson populli SPAK, se shihet drejtësinë e bërë, apo sepse argëtohet nga spektakli, argëtimi dhe shpagimi? Pra, nëse po dënohen dhe burgosen disa vetë në vend-sa mirë, oh, ç'u kënaqem! - a po vendoset vërtetë drejtësia? Miratimi popullor për dënimet e SPAK është si ndeshjet e

përgjakshme të gladiatorëve në Romën e lashtë, ku populli kërkonte dënimin duke ulur gishtin poshtë apo faljen me gishtin lart.

Është pra një pjesëmarrje në linçim më shumë se vendosje e balancës në

peshoren e drejtësisë.

Nuk është vetëm linja logjike që lidh apo ndan gjërat, që e përmbys aprovimin me 70 përqind për SPAK-më së pari si amatorizëm-por edhe vetë 'gjuha' dhe 'gjuha e trupit' të sh-



efit të SPAK, Dumani.

Në përballjen me deputetët në raportimin vjetor të veprimtarisë së institucionit, z.Dumani nuk u soll për asnjë moment si shefi i një 'partie' që ka 70 përqind, por sikur nuk përfaqësonte më shumë se 0.7 përqind. Mund të ketë në këtë rast një shpjegim të tipit: nuk ka përvojë publike dhe është i intimiduar nga skena e madhe, ndërkohë që ata përballë tij kanë një apo dy dekada në përplasje politike.

Nuk është kjo, sepse gjuha e trupit komandohet nga 'kode' të brendshme, jo ndikime të jashtme, dhe mimika e Dumanit nuk ishte e një rishtari në përplasje, por e një të kompleksuar apo të dikujt që sikletoset kur ajo që thotë dhe ajo që din janë në kontradiktë. Si kur u pyet për arrestimin e Berishës, si për incineratorët, si për 'vijën e kuqe', shefi i SPAK përçoi këtë kontradiktë.

Në këtë mënyrë ai kontradiktoi edhe sondazhet 'miqësore'.

PLAÇKITJA E PARAQITUR SI 'KRIM INTELEKTUAL'

Cilido qoftë 'besimi popullor' për SPAK, e vërteta është e thjeshtë: Prokuroria e Posaçme ende nuk 'ka hedhur në erë' asnjë prej çështjeve të mëdha të korrupsionit ekonomik dhe politik. I ka trajtuar po, shterruar jo.

Të fshehurit e mos-suksesit pas shprehjes se 'krimi është intelektual' dhe si i tillë i sofistikuar dhe i vështirë për t'u zbuluar, është një fyerje më vete (jo për popullin, por për publikun). Vjedhje më të trasha se këto të dekadës socialiste nuk mbahen mend në Shqipëri që nga viti 1913 kur nëpër atdhe poshtepërpjetnin disa ushtri të huaja e qindra banda plaçkitësisë vendas.

Plaçkitja nuk është 'krim intelektual', është një marrje me forcë në sy të të gjithëve, shoqëruar me parajamërimin: mos e hap gojën!

Te arsyet e mos-hapjes së gojës mund të gjenden edhe ngërçet në gjuhën e trupit të z. Dumanit.

LUTFI DERVISHI

Operacioni: PPP

Tashmë nuk ka dyshim se Shqipëria ndodhet para një lufte hibride shumë të sofistikuar që synon shkretimin e turizmit. Agjencite inteligjente kanë zberthyer një plan që vepron prej vitesh, por që u bë publik vetëm gjatë 48 orëve të fundit.

Agjencia ruse, në bashkepunim me atë serbe dhe të një vendi tjetër që për momentin nuk është bërë publik, gjatë viteve të fundit, ka vënë në zbatim operacionin e koduar PPP (plazhet pa pushues). Raportohet se këtij plani i është bashkëngjitur së fundmi edhe Greqia, që siç dihet, mban ende në fuqi ligjin e luftës!

1. Agjente të maskuar si turistë

Sipas raporteve të besueshme të SHISH, agjentë të huaj, të infiltruar si turistë, gjatë dy tre viteve të fundit, kanë folur me pronare hotelesh, veçanërisht në Jug të Shqipërisë, Vlorë, Sarandë, Ksamil, duke u qarë hallin për çmimet. Shumë lirë! Gjynah! Ketu është më mire se në Maldive. Parajsa mbi tokë! Mos u bëni budallenj rrisni çmimet! Dhe... ne, që fjalën e të huajt e dëgjojmë më shumë se fjalën e prindit, rritem çmimet pa e ditur se po beheshim bashkepunetore të armiqve traditional të Kombit shqiptar, që historikisht na kanë hapur varrin.. me duart tona.

2. Biznesi i Shezlongëve

Të pakënaqur me sabotimin e hoteleve, agjencia ruse në bashkepunim me atë serbe kanë penetruar deri në qeveri dhe veçanërisht në ministrinë e Turizmit për të nxitur me ligj një biznes krejt të veçantë të pa dëgjuar në pellgun e Mesdheut dhe në historinë boterore të turizmit. Ata kanë nxitur, mbeshetur dhe sponsorizuar biznesin e shezlogjeve- janë mbi 1400 biznese të tilla nga Velipoja në Ksamil. Operacioni "Pikaso" (Le të ketë shezlongë," por të jenë më të shtrenjtë se një veper e Picassos!) ka vite që është në zbatim. Hapesirat e plazheve krahas hoteleve u janë dhënë individëve që nuk kanë asnjë aftësi tjetër veç aftësisë për të thithur si magnet idete e armiqve tanë. Pa e kuptuar zyrtarët tanë duke menduar se po bëjnë mrekulli kanë bërë marrëzi! Tani, çdo pushues duhet të paguajë nga 10 deri në 100 euro për të qëndruar në hije! Nga informacionet e një shërbimi partner perëndimor mesohet se agjentit që ka dhënë këtë ide i është lidhur pension i përjetshëm.

3. Supermarketet

Agjencitë e huaja me një plan të mirëmenduar kanë shtrirë tentakulat e tyre edhe te Autoriteti i Konkurrencës dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit duke bërë të mundur që djathi në supermarket tona të jetë më i shtrenjtë se në Paris, sallami më i shtrenjtë se në Romë dhe buka më e shtrenjtë se në Gjermani. Kështu, tregtarët shqiptarë janë bërë



bashkëpunetore të pavetëdijshëm në këtë komplot të madh, duke ofruar mallra me çmime aq të larta sa turistët të mendojnë 12 herë para se të futen sërish në supermarketet tona.

4. Uji!

Agjentët e huaj me metoda të sofistikuar, vijon raporti i SHISH, kanë bindur autoritetet të mos bëjnë asnjë perparim në trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me ujë të pijshëm. Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza te ndertuara dhe vënë në funksionin para 10 vitesh nuk punojnë ndërsa ka një plan të detajuar që premtimi i lashtë për ujë të pijshëm 24 orë të mbetet gjithë jetën premtim. Operacioni "rubinetat e thata" është në veprim prej 33 vitesh dhe parashikohet të mbyllet në vitin 2124!

5. Rrugë të floringjta

Megjithëse ka zera se agjencitë e huaja në bashkepunim me agjentët lokal kanë rritur kostot e ndërtimit të rrugëve, në dorë të SHISH ka rënë një email me subjekt: "te mesojme kosovaret?"

Në tekst thuhet se Kosova ka ndërtuar dy prej autostradave më të mira në rajon, por kosovaret nuk janë mësuar të paguajnë në rrugë, sepse qeveria në

Prishtinë nuk pranon të vendose tarifa. Është detyrë e Shqipërisë, që përmes tarifave në rrugë në monedhen që ata përdorin (euro) të mesojë shqiptarët e Kosovës se si paguhet ndërkohë që vozit në rrugë. Objektivi është që udhëtimi me makinë të bëhet me i shtrenjtë se udhëtimi me avion.

6. Goditja e madhe

Së fundi, në një goditje spektakolare, agjentët e huaj në bashkepunim me krimin e organizuar shqiptar dhe atë ndërkombëtar kanë zhvlerësuar euron. Euro e dobësuar është garanci shtesë që të ketë sa më pak të huaj dhe shqiptarë të Kosovës. Bashkepunimi për këtë pikë shtrihet sa nga drejtoria e pastrimit të parave aq edhe te sistemi i drejtësisë dhe ai bankar.

7. Greqia

Raporti verën se veçanërisht pas çështje Beleri, Greqia, që vjet kapi 36 milionë turistë, është hedhur në sulm për të demtuar sezonin turistik në Shqipëri. Është dora greke (pavarësisht se nuk ka prova) që Shqipëria po telendiset këto ditë nga UNESCO per Butrintin, Berat, Gjirokastren.

Nëse shikoni ndonjë të huaj që pi

koktejl në Jug, buzeqesh me pamje të lumtur dhe thotë sa lirë është këtu me siguri është agent rus, serb ose grek. Nëse këto fjalë i thotë në një plazh që është bosh, me siguri është poliagjent që po shijon rezultatet e operacionit PPP (plazhet pa pushues)

SPAK heton për plazhet bosh?!

Pse plazhet tona që lënë pas Maldivet janë zbrazur këto ditë sikur të jetë kthyer Covid? Janë çmimet? Shërbimet? Me pak pushues nga Kosova apo komploti i shërbimeve të huaja që kanë nisur një fushatë dezinformimi në shkallë të gjerë siç u tha sot në Parlament?

1. Çmimet

Imagjinoni, nëse mundeni në këto ditë të nxehta një plazh në Jug të vendit, që ka një tarifë ditore kaq të lartë sa të duket sikur nuk ke shkuar për pushime, por po merr pjesë në

ankand. Çmimet kanë fluturuar kaq lart a thua se rëra është importuar nga hëna, rrezet e diellit duhen paguar si rrezet lazer në spital, ndërsa hija e çadrave është kaq e çmuar sa ja vlen të marrësh një kredi konsumatore! \

2. Shërbimet.

Pasi e marrë një (mikro)kredi për të përballuar çadrën e plazhit, përgatituni për shërbimin. Por nëse te mungon durimi më mirë mos u nis për pushime! Restorantet e plazheve janë të njohura për shpejtësinë e tyre të jashtëzakonshme – dreka mund të mbërrijë vetëm pak para se të ngrysë dielli.

3. Eksodi i patriotëve

Ndërkohë, pushuesit nga Kosova, deri dje të quajtur turistë patriotë, sot kanë zbuluar plazhe që janë jo vetëm më të lira, por edhe me shërbim më të mirë. Greqia, Mali i Zi, Turqia i mikpresin me krahë hapur, duke lënë Jugun tonë po aq të vetmuar sa ekipin anglez pas humbjes së Europianit.

4. Sabotim

Sikur të mos mjaftonin çmimet e larta dhe shërbimi i dobët, tani jemi para një komploti. Sipas disa deputetëve, plazhet e braktisura nuk janë për shkak të çmimeve dhe shërbimeve, por jemi para një fushatë malinjë nga shërbimet e huaja inteligjente. Është e qartë se misioni i fundit i KGB-së, Asfalise, SIM dhe BIA është që askush të mos shijojë rrezet e diellit në Dhermi apo një hije çadre në Jalë! Një deputet i shumicës sot, me zellin e një detektivi në një film horror, i kërkoi SPAK të hetojë këtë akt të pashembullt sabotazhi me të cilin po përballlet vendi. A po përhapin agjentë të huaj dezinformata për të dekurajuar turistët? A ka një komplot të fshehtë për të minuar mikpritjen tonë tradicionale? Si ka mundësi që turistët të habiten me çmimet e mallrave në supermarketet që janë më të shtrenjta se në vendet e BE-se? Si ka mundësi që leku të jetë më i fortë se euro, paundi dhe franga zvicerane?

Para kësaj pyetje Kreu i SPAK, ngriu në podiumin e Kuvendit ndoshta duke pyetur veten: si ka mundësi na ka shpëtuar kjo aferë kaq e madhe konspiracioni? Në këtë rast, duket se edhe Sherlock Holms do të mbetej pa tekst.

5. Epilogu:

Pse pra plazhet tona janë bosh? Dërisa ta zgjidhim këtë mister, plazhet e Jugut do të mbeten një testament i marrëzisë dhe mentalitetit KÇK (kap çfarë të kapësh) në turizëm dhe propagandës së 10 milionë turistëve që po magjepsen me Shqipërinë.

BLICK": VIZITONI SHQIPËRINË – VENDIN MESDHETAR ME PASURI HISTORIKE DHE KULTURORE

Shqipëria po lulëzon dhe numri i turistëve në vend po rritet me shpejtësi. Ne vizituam vendin ballkanik dhe zbuluam fshatra të vegjël magjepsës dhe një ndjenjë autentike për jetën, sipas një artikulli të botuar në të përditshmen gjermane "Blick".

Vizita në Shqipëri kërkon një ndjenjë aventure – dhe pikërisht kjo është arsyeja pse një udhëtim rrugor është e vetmja mënyrë për të depërtuar në vendin ballkanik.

Na u desh pak më shumë se një javë për të eksploruar pikat turistike në jug të vendit: Liqenin mistik të Ohrit, Parkun Kombëtar të pyllëzuar të Llogorasë, zonën arkeologjike të Butrintit dhe vendet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s të Gjirokastres dhe Beratit.

Vendet kryesore të Tiranës

Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana është plot ngjyra. Kaloni disa ditë në qytetin me 400 000 banorë.

Kushdo që viziton kryeqytetin shqiptar duhet të shijojë edhe kulturën e kafenesë dhe pub-it, e cila ka një traditë të gjatë në Shqipëri.

Tirana karakterizohet nga jeta e gjallë e natës në zonën e Bllokut, ku dikur jetonin politikanët komunistë.

Gjithashtu, në qytet po krijohen gjithnjë e më shumë restorante kreative **Shumë sundimtarë gjatë shekujve**

Shqipëria ofron një ndërthurje të kulturës dhe historisë.

Falë vendndodhjes së saj në qendër të Ballkanit, rajoni pati shumë sundues gjatë shekujve: grekët e lashtë, romakët, bizantinët dhe, për rreth 500 vjet, osmanët turq.

Të gjithë ndihmuan në formësimin e vendit dhe këta të fundit lanë gjurmë jo vetëm në arkitekturë dhe kuzhinë, por edhe në besim.

Veçanërisht Berati, me shtëpitë e tij



osmane dhe rrugët e ngushta të shtrura me guralecë të Lumit Osum – është një Perlë.

Infrastruktura turistike

Berati, si i gjithë vendi, është në një udhëkryq. Shumë njerëz po lëvizin nga shtëpitë shekullore në qytetin e ri, i cili ka formuar një unazë rreth bërthamës së vjetër.

Biznesmenët po investojnë në ndërtesat historike dhe po i shndërrojnë ato në hotele, restorante dhe dyqane.

Pas pak vitesh, qytetet e vjetra do të bëhen parqe historike – siç ka ndodhur tashmë në shumicën e vendeve turistike rreth Mesdheut.

Koha më e mirë për të vizituar Shqipërinë është – tani!

Butrinti

Butrinti ndodhet në jug të vendit – dhe u shpall një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 1992. Ju mund të shihni tempuj, rrugë, teatro dhe kisha – që nga periudha e grekëve të lashtë, romakëve, të krishterëve të hershëm dhe osmanëve. Mos e humbisni një vizitë në muzeun arkeologjik, ku mund të eksploroni gjëjet më të mira në gadishull.

Gjirokastra

Gjirokastra ndryshe quhet edhe "Qyteti i Gurtë".

Shtëpitë në qytetin malor – me rreth 20 000 banorë – janë ndërtuar nga

guri gri vendas, me të cilin janë mbuluar edhe çatitë.

Në qytetin e vjetër ndodhen rreth 600 ndërtesa të periudhës osmane (shek. XV- XIX), kjo është arsyeja pse Gjirokastra u bë gjithashtu një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2005.

Gjithashtu, mund të vizitoni disa nga shtëpitë e dekoruara në mënyrë madhështore, siç është "Shtëpia e Zekatëve", e cila ngrihet mbi qytetin e vjetër apo xhamitë.

Alpet Shqiptare

Malet në veri të vendit njihen edhe si Alpet Shqiptare.

Majat e tyre arrijnë më pak se 3000 metra, malet me luginat e tyre të gjel-

bërta dhe pyjet e dendura janë një Perlë e vërtetë.

Rrëqebullët, ujqërit dhe arinjtë kalojnë fshehurazi nëpër shkurre dhe shqiponjat qarkullojnë rreth majave. Përveç ecjes, mund të bëni edhe rafting.

Bukuri originale

Ne u kthëm në qytetin e Himarës pas përdimit të diellit, kur njerëzit ishin duke shëtitur përgjatë mini-shëtitorës. Himara ka një bukuri origjinale që nuk do ta gjeni në shumë destinacione pushimesh.

Nga qyteti i Himarës, afërsisht në mes të detit Jon, një shteg i zhvilluar ecjeje përshkon rrugën në veri drejt gjireve të ndryshëm shkëmbor.

Riviera Shqiptare

Shqipëria krenohet me plazhet fantastike, ushqimin e thjeshtë por shumë të shijshëm dhe natyrën ende të pacënuar.

Plazhet në jug në detin Jon, e ashtuquajtura Riviera Shqiptare, janë më të bukura se ato në veri.

Një nga plazhet më të bukura është Plazhi i Gjipesë, i cili mund të arrihet vetëm në këmbë ose me automjet fuoristradë

Ia vlen të ecësh gjysmë ore për në plazh. Folie Marine – Hotel & Beach Club ndodhet në plazhin e Jalës.

Ky është bari ideal për turistët që duan të kërcejnë rreth pishinës deri herët në mëngjes në korrik/gusht.

Gjithashtu, vizitoni Syrin e Kaltër. Ky burim ujor është më i pasuri në vend – me ngjyra mbresëlënëse.

KIM MEHMETI

Duaja Shqipërinë edhe atëherë kur treqind kilometrat nga Shkupi deri në Milot i kalon për tre orë, e njëzet kilometrat nga Miloti deri në Lezhë për dy orë, sepse atë e drejtojnë njerëz që nuk e kanë kuptuar se rrugët janë 'damarët' e tokës. Dhe se kur ato mbyllen, siç ndodhë shpesh në Shqipëri, atëherë shteti përjeton 'infarkt'.

Vazhdo ta duash Shqipërinë edhe kur e dinë se gjysma e qeveritarëve të saj janë në burg. Dhe mos ia dëshiro zvogëlimin e numrit të pushuesve as kur e dinë se në bregdetin e saj jugorë ndërtojnë hotele e shtëpi luksoze edhe narko-mafiozët dhe hajdutët e Bashkisë së Tiranës, edhe atë jo pse duan ta zhvillojnë turizmin, por që t'i pastrojnë parat e pista dhe t'i fshehin ato që ia kanë vjedhur popullit.

Shqipërinë duhet dashur edhe më shumë sot kur ajo ka elita mjerane të pandjeshme ndaj fatit kolektiv të shqiptarëve. Pra sot kur 'mendimtarët' e saj të 'pavarur' i kalojnë pushimet në jug, ku japin nga njëqind euro për një shezllon, ngaqë Piktori ua paguan shtrenjtë hesh-

DUAJE SHQIPËRINË EDHE KUR ATË E DREJTOJNË HAJDUTËT E 'RILINDJES'



jen e të vërtetave si dhe, rolin e 'vajtoj-cave' të shtirura të përnatshme nëpër

ekranet televizive.

Duaja pa kushte Shqipërinë edhe kur nuk mund të pushosh në bregdetin e saj ju-

gorë, por në Velipojë, aty ku nuk të shoqërojnë djemtë me makina të shtrenjta që ua kanë blerë baballarët hajdutë, e as bukuroshet që në trup kanë më shumë silikon e botoksë se sa muskuj.

Pra Shqipërinë duhet dashur gjithmonë, edhe kur pushon mes gjyshërve 'skamnore' që asaj ia kanë dhuruar rininë, e që tani kujdesen për nipërit e mbesat e tyre si dhe, mes djemve e vajzave që i mbajnë për dore prindërit e tyre pleq, e të cilët nuk i freskon gjithaq uji i detit, sa kujdesi dhe dashuria e pasardhësve të tyre.

Duaja dhe ndihmoje edhe më shumë Shqipërinë e sotme, këtë që e drejtojnë hajdutët e 'Rilindjes', e të cilët ndaj saj sillen si piratët ndaj anijes që u ka rënë në duar: pasi ta plaçkitin, të duan edhe ta fundosin. Që kurrë as ata vetë të mos e marrin vesh se cili prej tyre çka dhe sa ka vjedhur prej saj.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545

ANDI BUSHATI

MË MIRË "M" ... SESA I VARFËR

Në Shqipëri përbën mallkim të jesh i varfër. Ky është konkluzioni i parë dhe i vetëm i skandalit të mikro kredive, që prej disa kohësh, po rrihet mbarë e prapë, duke anashkaluar në mënyrë ulëritëse thelbin.

Disa synojnë ta lënë përgjegjësinë te Banka e Shqipërisë, një palë e dytë mëton të drejtojnë gishtin tek qeveria dhe ministria e Drejtësisë, që kanë dështuar të kontrollojnë një tufë përmbaruesish abuzues, ndërsa të tjerë fajësojnë parlamentin që ka neglizhuar të ngrejë kuadrin e nevojshëm ligjor për të ndaluar krimet e monstrave të financës. Por edhe në këtë rrëmujë opinionesh, se kuji do t'i mbetet faji, pak kush kujtohet për viktimat e vërteta, ata nga 30 mijë deri në 100 mijë (nuk ka transparencë për shifrën) që përbëjnë pjesën më të vobektë dhe vulnerabël të shoqërisë.

Simboli i tyre u bë Pal Trashaj, që i dha fund jetës një muaj më parë në dyert e SPAK, pasi nuk e përballonte dot më lakun e borxheve që po i merre frymën. Ai u largua nga kjo jetë vetëm për 76 mijë lekë kredi, që pati marrë plot 16 vjet më parë, kamatat e së cilës vijonin ta përndiqnin si hije.

Për të kuptuar historinë e tij dhe të shumë të ngjashmëve të vet, duhet njohur pak ecuria e ngjarjeve. Në vitet 2015- 2016, sistemi ynë bankar ishte në prag të kolapsit. Bankat e nivelit të dytë numëronin në portofolin e tyre gati 25% kredi të këqia. Qeveria Rama 1 dhe ministria e Financave u angazhuan vetë për të ristrukturuar dhe lehtësuar borxhet e më të mëdhenjve. Për të vegjlit, për ata që kishin marrë borxh sa për të mbajtur ndonjë biznes gjallë, apo për të mbyllur ndonjë brimë në shtëpi, u zbatua një skemë tjetër. U bë ligji për krijimin e kompanive që mblidhnin këto kredi të pashlyera.

Dhe pikërisht këtu, bashkë me lejimin



e kompanive të mikro kredive, u krijua një skemë mafioze. Financierë, përmbarues privatë, noterë e gjyqtarë formësuan lidhje okulte, që me anë kërcënimesh e mashtrimesh t'u rrëmbenin kredimarrësve të vegjël deri tetëfishin e shumës që ata patën marrë hua dikur. Me metoda brutale, përmbaruesit shantazhonin të pambrojturit me sekuestrimin e pasurive dhe me nxjerrjen nga shtëpia. Pas tyre i vinte radha "dorës së ngrohtë" të financierëve që ofronin zgjidhje duke dhënë një mikro kredi me kushte robëruese për të larë të parën. E kështu, ai që kishte pasur dikur nevojë për një grusht lekësh, shndërrohej në

mënyrë të pakthyeshme në viktimë.

Kjo skemë është bërë tashmë e njohur nga zberthimi që i ka bërë prokuroria, që ka çuar edhe në sekuestro dy nga kompanitë abuzuese, por pyetja që shtrohet pas zbulimit të saj është: si askush nuk e vuri ujin në zjarr për më të pambrojturit?

Po të ndjekësh sagën e këtij skandali, kupton se ekzistonte një merak i shtuar për të shëruar bankat nga kreditë e këqia, se u bë ç'mos për të reduktuar borxhet e kapitenëve të oligarkisë, por se askush nuk e çau kokën për ata dhjetra mijëra vikima

që u lanë në mëshirë të fatit.

Pse ndodhi kështu?

E gjithë kjo neglizhencë për të mbrojtur hallkën e fundit të zinxhirit, kjo harresë për fatin e më të dobhtëve, e ka një sfond dhe një shpjegim. Vendi sot qeveriset nga një forcë politike, e mbështetur nga një kastë e verbuar nga etja për fitim, e cila e konsideron si faj dhe turp varfërinë dhe që as nuk e ka në radarët e vet solidaritetin me të prekurit prej saj. Jo më kot, që në nisje të erës rilindase, shefi i saj i ftoi investitorët e huaj të zbarkonin në këtë vend ku punëtorët shfrytëzo-

heshin më lehtë, pasi nuk ekzistonin sindikatat. Jo më kot, shumë vite më pas, ai u bëri thirrje biznesmenëve vendas të punësonin bangladeshas dhe t'i zbonin ata pasi të mësonin shqip dhe të tuboheshin për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Partia që erdhi në pushtet duke ulëritur për padrejtësinë e 5% të shqiptarëve që kishin pasuri sa 95%-shi tjetër i popullsisë, përfundoi duke i shtuar pabarazitë në vend. Sot, në parajsën turistike të kontinentit, më shumë se gjysmës së popullsisë nuk ia mban xhepi të shkojë me pushime. Është e njëjta gjysëm që sipas studimeve ndërkombëtare rrezikon të bjerë në mjerim, duke jetuar me më pak se 5 USD në ditë.

Në këtë filozofi e merr përgjigjen edhe pyetja naive se si që e mundur që askush nuk u kujtua për të mbrojtur viktimat e vrasësve financiarë që shpunë drejt vetëflijimit Pal Trashaj. Atë e kupton edhe më mirë, kur shikon se një parlament, që nxiton të prodhojë ligje me procedurë të përsheptuar për teatrin e Fushës, për portin e Alabarit apo për Zvërnecin e Kushnerit, nuk u kujtua për mbi një dekadë t'u vinte tavan kamatave marramendëse që vrisnin më të varfërit.

Këtu qëndron thelbi i skandalit të mikro kredive. Prandaj përgjegjësia nuk mund të mbetet jetime në ping pongun që bëjnë institucionet për t'ia lënë fajin njëra-tjetrës. Ajo është shumë më e thellë sesa kaq. Ajo është simptomë e një vendi ku askush nuk merakoset për më të dobët dhe më të pafuqishmin. E një shoqërie të cilës, kapitalizmi i egër, ia ka ndryshuar fjalën e fundit të shprehjes së dikurshme: "më mirë M... sesa i vogël". Tani aty mund të lexosh "i varfër".



NA GJENI
NE FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

ENVER ROBELLI

Shkrimtarët e rëndësishëm i gjejnë përgjigjet e rëndësishme. Te vepra e madhe e Franz Kafkës – po e përmendim këtu për shkak se sivjet mbushen 100 vjet nga vdekja e tij – lexuesi e lexuesja mund të zbulojnë shumë anë të karakterit njerëzor. Në tipologjinë e figurave, Kafka skicon (edhe) tiparet e errëta, të këqija, mizantropë të qenieve njerëzore. Këtu dallohet egoisti, që fajin e kërkon vetëm te tjetri dhe pafajësinë e sheh si pronë të tij. Nga egoizmi tek injoranca distanca nuk është kilometrike, por milimetrike. Injoranca pastaj përzihet me një dozë thashethemesh, me mungesë respekti ndaj dinjitetit të tjerëve, me përbuzje të suksesit të tjerëve si ngushëllim qesharak për dështimet personale. Ky është njeriu me zemër të ftohtë. Te “Kolonja ndëshkimore” e Kafkës është një makinë që përmes një procedure trishtuese gozhdon njeriun. Franz Kafka ishte vizionar. E parashikonte që një ditë njeriu-makinë do të shkapet nga ndjenjat dhe do të vrasë njeriun me ndjenja

2. “E sheh diellin duke perënduar ngadalë dhe prapëseprapë trembesh kur befaz gjithçka errësohet”. Ka shumë mendime të errëta në veprat e Franz Kafkës. Ai vdiq i ri, në vitin e 40-të të jetës. Por, si asnjë autor tjetër ai vazhdoi të jetonte. Vazhdon të jetojë. Falë dijetarëve si Reiner Stach. Ky gjerman i lindur më 1951 ka punuar 18 vjet (!) për të shkruar biografinë e Franz Kafkës. “Vitet e hershme” (“Die frühen Jahre”), “Vitet e të kuptuarit” (“Die Jahre der Erkenntnis”), “Vitet e vendimeve” (“Die Jahre der Entscheidungen”) – këta janë titujt (në gjermanisht) të opusit prej tri vëllimesh. 2000 faqe. Një jetë e rrëfyer minutë pas minute.

3. Një ditë në moshën 40-vjeçare Franz Kafka po kalonte nëpër një park në Berlin. Me atë rast takoi një vajzë, e cila po qante, sepse kishte humbur kukullën e saj më të dashur. Ajo dhe



Kafka e kërkuar kukullën, por nuk e gjetën. Kafka i tha vajzës se do të takoheshin të nesërmen në vendin e njëjtë në park për të vazhduar kërkimin e kukullës. Ditën tjetër, pasi nuk e gjetën kukullën, Kafka ia dorëzoi vajzës një letër “të shkruar” nga kukulla. Në letër thuhej: “Të lutem, mos qaj! Jam nisur në një udhëtim për të parë botën. Do të shkruaj mbi aventurat e mia”

Kështu filloi një histori që zgjati deri në fund të jetës së Kafkës (ai vdiq në moshën 40-vjeçare). Gjatë takimeve Kafka ia lexonte vajzës letrat e kukullës, të cilat ishin shkruar me kujdes mbi aventurat dhe bisedat e saj. Vajza magjepsëj. Dikur Kafka e solli kukullën dhe tha se ajo ishte kthyer në Berlin. (Në të vërtetë Kafka e kishte blerë një kukull tjetër).

“Kjo kukull fare nuk i përngjan kukullës sime”, tha vajza.

Kafka ia dha vajzës një letër tjetër në të cilën kukulla shkruante: “Udhëtimet më kanë ndryshuar”. Vajza e vogël përqafoi kukullën e re dhe e lumtur e mori me vete në shtëpi.

Kafka vdiq po atë vit.

Shumë vjet më vonë vajza tashmë e rritur gjeti një letër brenda kukullës. Në atë copëz letre, të nënshkruar nga Kafka, thuhej: “Gjithçka që do, me gjasë do të humbë, por në fund dashuria do të kthehet në një mënyrë tjetër. Pranoje ndryshimin. Është i pashmangshëm që të rritesh. Së bashku dhimbjen mund ta shndërron në mrekulli e dashuri, por është në dorën tonë që këtë ndërlidhje ta krijojmë me vetëdije dhe me qëllim”. Rrëfimi mbi letrat e kukullës të shkruara nga Kafka gjendet në vëllimin “Als Kafka mir entgegenkam... Erin-

nerungen an Franz Kafka” të Hans-Gerd Koch.

4. Nga viti 1889 deri më 1893 Franz Kafka vizitoi shkollën e djemve të gjuhës gjermane në Pragë. Në të gjitha lëndët mësimore ishte shumë i suksesshëm – me përfundim të gjimnazit dhe artit figurativ. Në këto dy lëndë mori notën “mjaftueshëm”. Notat më të mira i mori në lëndët “zelltari” (të qenët i zellshëm) dhe “sjellje e moralshme”. Gjatë tetë vjetëve të ardhshëm në gjimnazin shtetëror, në pjesën e vjetër të Pragës, Kafka nuk ishte nxënës aq i mirë. Interesimi i tij për mësim u zbeh sapo hyri në moshën e pubertetit. Ai vazhonte të ishte nxënës i mirë vetëm në lëndët gjuhësore, por në vitin e maturës edhe në lëndën e gjermanishtes u vlerësua vetëm me notën “kënaqshëm”. Problemet më të mëdha Kafka i kishte me matematikën. Shifrat kundër shkronjave? Franz Kafka vendosi për shkronjat. Dhe u bë shkrimtar.

5. Më 1918 Evropën e përfshiu gripi spanjoll. Në Pragë u infektua pacienti Franz Kafka. Më 14 tetor erdhi mjeku. Kafka, 40-vjeçar, ende banonte te prindërit. Aq shumë e kishte lodhur sëmundja, sa që nuk mund të transportohej në spital. Kafka ishte shëndetligë, sepse më 1917 ishte prekur nga tuberkulozi. Tani, më 1918, lëngatës së tij i ishte shtuar edhe gripi spanjoll. Ndërsa qëndronte në karantinë, një pacient tjetër luftonte për mbijetesë: Perandoria Austro-Hungareze. Çekët kërkonin autonomi, dëshironin të braktisnin mbretërinë danubiane, presidenti amerikan Woodrow Wilson përkrahte të drejtën e tyre për pavarësi. Nga dritarja e banesës familja Kafka u bë dëshmitare e themelimit të shtetit çek. Kur u infektua nga gripi spanjoll, Kafka

ishte shtetas austro-hungarez, kur doli nga karantina pesë javë më vonë ai jetonte tashmë në shtetin e ri çek. Stacioni i trenit Franz Joseph në Pragë kishte ndërruar emrin: quhej Stacioni i Trenit Wilson (për nder të presidentit amerikan). Punëdhënësi i Kafkës, një firmë sigurimesh, kishte vendosur që çekishtja të jetë gjuhë zyrtare. Në pasaportën e re Franz Kafka quhej František Kafka. Brenda pesë javësh mund të ndodhin shumë gjëra.

6. Vite më parë një nxënës 15-vjeçar në Gjermani pranoi një dhuratë: një koleksion me pulla postare. Mes pullave ai gjeti një zarf. Letra i dërgohej “Zonjshës Felice Bauer”, dërgues ishte: “Dr. F. Kafka”. Vula postare tregon se letra është dërguar më 1 korrik 1913 nga Praga. Zarfën e gjetur nxënësi, ia dhuroi Arkivit të Letërsisë Gjermane në Marbach, ku mbledhet, ruhet, arkivohet e koleksionohet çdo gjë e shkrimtarëve të rëndësishëm të gjuhës gjermane. Zarfë është i zbrazët, letra është blerë më 1987 në New York – nga një evropian i panjohur. Gjetjes së një zarfi të zbrazët gazeta gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung” ia ka kushtuar gati një faqe gazetë (në vitin 2021). Kafka u fejua dy herë me Felice Bauer, por s’pati guxim të martohej. Më 27 dhjetor 1917 pasoi ndarja përfundimtare. “Nganjëherë më duket se truri dhe mushkëritë janë marrë vesh pa dijen time. ‘Kështu s’shkon më’, tha truri dhe pas pesë vjetësh mushkëritë u treguan të gatshme të ndihmonin”, ka shkruar Kafka. Një dashuri tragjike krijoi një nga veprat më të rëndësishme letrare të shekullit të 20-të: romanin “Procesi”. U botua më 1925, një vit pas vdekjes së Kafkës, dhe e bëri Kafkën: të pavdekshëm!

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 

Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



NDUE DEDAJ

NËSE PROFESIONISTËT DO TË KISHIN FOLUR...!

Nëse profesionistët, specialistët dhe ekspertët e fushave të ndryshme, ata “pa parti”, do të kishin folur hapur, me guxim dhe trimëri intelektuale, në vendin dhe në kohën e duhur, Shqipëria shumë gjëra do t’i kishte ndryshe nga sot, më mirë e më mbarë. Nëse arkitektët e Tiranës do të kishin qenë luftarakë në idetë dhe qëndrimet e tyre, ka gjasë që kryeqyteti ynë të ishte sot pa kullat “dubaitiane”, me gjithë autor(itar)sinë e kryeministrit dhe kjo marrëzi nuk do të kishte nxituar drejt Shkodrës, për ta shfytëruar qytetin autentik të Rozafës, kinse me një “Rozafë” moderne, që nuk të krijon asnjë ndjesi të së bukurës në atë mjedis. Të gjithë presin arkitektët, urbanistët të thonë është mirë apo keq kjo gjë? Çfarë do të thoshte Arkitekt Sinani, që nuk ndërtoi vetëm në Orient, por edhe në Vjenë, Romë e deri në Vlorë – do të ishte për dyzet kulla apo për dyzet çezma në Tiranë, sigurisht pa e kthyer kryeqytetin e shqiptarëve në Stamboll, por as duke e fshirë “Stambollin” e këtushëm me pahir, duke i mveshur një tjetër orient...!

Këtu flasin të gjithë dhe për çdo gjë, vetëm ekspertët e fushave jo! “Nuk të dëgjon kush”, – thonë. A nuk u ngritën artistët në protestë, me ditë e me net, në mbrojtje të Teatrit Kombëtar, po kush i dëgjoji? E shembën se e shembën pushtetarët. Po e ndanë mendjen këta tanët, e bëjnë, nuk është si në Europë ku nuk mund të ngulësh një gozhdë jashtë interesit publik. Kështu ka ndodhur gjithmonë. Kë pyetën ata që shembën dikur godinën e Bashkisë së Tiranës, për të ndërtaur në vend të saj Muzeun? Pikërisht kjo psikologji kryeqeveritarësh, prej të gjithëpushtetshëmish kërkon përballe të “gjithëpushtetshme” publike, kryekrejt nga profesionistët. Sidomos në kushtet e një opozite të dërmuar politikisht, për njëqind (mos)arsye, elita intelektuale është e vetmja kabanë që mund të dëgjohej, edhe pse mungon krejtësisht vullneti i qeverisë për të dëgjuar opinionin publik, opozitën, zërat ndryshe, aq më pak ata kundër.

Qytetarët nuk pyetën as për instalacionet që vihen në kryqëzime rrugësh, u vu një “çelës” në Shkodër dhe nuk dimë të ketë folur ndonjë urbanist, i shkon apo nuk i shkon një simbolikë e tillë një qyteti me kështjellë të lashtë etj.. Por, profesorët nuk flasin! Ata heshtin. “Zëri” i tyre është ai i heshtjes. Kanë folur në diktaturë, edhe pse e dinin se do të përfundonin në Spaç, e nuk flasin në demokraci. Duket e pabesueshme, por kështu është. Nuk është dhe aq frika sot, por mbase “blerja” e heshtjes me flori.

Nëse bankierët dhe ekspertët bankarë do të kishin folur publikisht duke i denoncuar mikrokreditë, këto të fundit nuk do të ishin shndërruar në vrastare të qytetarëve të thjeshtë dhe të vetë



bosëve të tyre. Ashtu siç nuk patën folur dikur profesorët e ekonomisë, ekspertët e saj për rrezikun e piramidave, çka do të kishte parandaluar tragjedinë kombëtare që ndodhi. Nuk ka folur as gazetaria investigative, pasi ajo në vendin tonë thajse nuk ekziston. Ne nuk kemi gazetarë – ekonomistë, gazetarë – juristë, gazetarë – ekologjistë etj. dhe programe që t’i mbështesin ata fuqimisht në investigimet e tyre delikate në botën e krimin dhe të mafies shtetërore. Në pamundësi për të bërë më të mirën, gazetarët tanë të këtij profili i vihen aferës korruprive fiks pasi ta ketë denoncuar opozita apo nisur hetimin Prokuroria. Teksa kemi opinionistë të shumtë televizivë, të zotët, po që duke folur përditë e për gjithçka e shpesh njëanshëm, e kanë humbur besueshmërinë publike. Prandaj lind nevoja e zërave të profesionistëve, që në njëfarë mënyrë do të vinin pikat mbi “i”.

Si është e mundur që shoqëria jonë gjendet herë pas here në pragje të tilla shkatërrimtare, si piramidat, inceneratorët, mikrokreditë, “Onkologjiku”, tjetërsimi dhe grabitja e pronave, betonizimi i bregdetit, hecizimi i lumenjve etj.? Pa u paralajmëruar për rreziqet e mundshme nga ekspertët përkatës, nga elita e vendit? Kur themi elita, nuk kemi parasysh ndonjë “kor” ku të bëhen bashkë disa zëra “kryengritës” për t’i bërë oponencë qeverisë, bashkive etj.. Fjala është për profesionistët që kanë emër të përveçëm. Ku janë ata? Pse nuk dëgjohej! Kjo nuk do të thotë se nuk mund të bëhen dhe dy a më shumë bashkë, që të reagojnë si një zë i vetëm, i peshuar dhe argumentuar, çka do të ishte më e mira. Tashmë nuk

përzihen në “punët e brendshme” as shqiptarët intelektualë të emigracionit, që dikur ishin zëra publikë mjaft të pëlqyer. Përmendet gjithandëj që për Vjosën tonë ka reaguar Lenardo Di Capro, por nuk kemi dëgjuar të ketë bërë diçka të ngjashme ndokush nga shqiptarët jashtë vendit, që qeveria i promovon në Tiranë me pompozitet, si të ishin Faik Konica apo Arshi Pipa. Na duket se jo pak veprimtari të kësaj natyre kanë për qëllim më shumë reklamën e qeverisë se promovimin e Shqipërisë jashtë.

Shoqëria, e dhënë pas interesave të çastit, ka ende “kultin” e shefave, zyrrave dhe zyrtarëve, ndërkohë që i sheh me indiferencë për sonalitetet e fushave të ndryshme, deri kur plas bomba sociale. Duhej të ndodhte tërmeti i 2019-ës që të “zbulonim” se kishim një inxhinierë ndërtimi klasi si Luljeta Bozo. Ajo nuk ishte ndonjë anonime, përkundrazi, profesore e universiteti prej një kohe të gjatë, mësonte fëmijët tanë në auditorë, kishte folur për rreziqet e ndërtimeve, herëherë pa “themele” të qëndrueshme të tranzicionit, por nuk ishte dëgjuar, u bë zë i fortë publik vetëm mbasi ndodhi gjëma, çka e bëri edhe deputete.

Po sikur Kuvendin ta kishim me më shumë “Luljeta” të sferave të ndryshme dhe me aspak individë që nuk i thonë asgjë lagjes së tyre, jo më Shqipërisë dhe shqiptarëve si ligjvënës. Asnjëherë nuk kanë munguar profesionistët e zotë, që falë angazhimit të tyre qytetar janë ngritur në nivele kombëtare, paçka se ku kanë banuar, si Ahmet Osja, që ishte gjithmonë një pikë referimi për bujqësinë shqiptare dhe Shkodrën e tij,

ashtu si Gjergj Vlasi për Durrësin, Vexhi Buharaja për Beratin, Thoma Papapano për Gjirokastrën etj.. Autoritetet morale të shoqërisë, shkrimtarë, artistë, akademikë, pedagogë, juristë, mësues, publicistë, sociologë, mjekë, ekonomistë, inxhinierë, arkitektë etj. pak besojnë në politikën dhe lidhshipet e saj, në shoqërinë e ashtuqajtur civile, ndaj dhe nuk përfshihen në to. Kjo i bën ata zëra më autentikë, që nuk paragjykohej, pa përjashtuar dhe individualitete të moderuara politike, që dëgjohej me respekt nga publiku kur flasin për kauza që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me qytetarët, si Alizoti, Alimehmeti, Shehu etj., nga krahu i opozitës, por dhe të tjerë.

Qeveria ka përgjegjësi se nuk këshillohet, nuk e dëshiron këtë gjë, këshilltarët që paguhen për këtë punë nuk pyetën për asgjë thelbësore, por nëse ata janë nën presion nga eprorët për të mos folur, pasi iu fluturon rroga dhe karriera, profesionistët që nuk janë pjesë e administratës publike, çfarë i pengon ta “këshillojnë” qeverinë dhe pa dëshirën e saj? Ekspertët e arsimit nuk duhet të zgjohen vetëm pas vlerësimit negativ të shkollës shqiptare nga PISA. Ata të bujqësisë nuk kanë më gojë pas dështimit të qeverisë me grantet e dhënë nga Bashkimi Europian. Bluzat e bardha duhet të ndihen para se të dalin sheshit skandalet e kolegëve të tyre. Në emër të reformimit të administratës shtetërore (që kurrë nuk u bë!), kemi një dyzinë inspektoratesh që kryqëzohen poshtë e përpjetë, pa kompetenca të qarta dhe efektivitet në punë. Për të njëjtin realitet apo subjekt – pyjet, mjedisin dhe Zonat e Mbroj-

tura – janë krijuar 5 – 6 sektorë e agjenci, (në bashki dhe në dy – tri dikastere), specialistët e të cilëve i bëjnë bashkë vetëm zjarret në verë!? Këto s’kanë si lihen kështu, por pse nuk bie kambana sot? Nesër mund të dalin plot e të thonë, kështu mendonim dhe ne, po kjo do të ishte si trimi pas luftës.

Sot për sot në betejë me të keqen duket sikur është vetëm SPAK dhe gjithë të tjerët presin me sytë nga godina me hekura, ç’po ndodh atje. Ky është veçse një iluzion. Atë që mund ta bëjë një publik i ndërgjegjësuar për fatet e veta, nuk e bën dot asnjë institucion shtetëror, pavarësisht rangut dhe mbështetjes ndërkombëtare. Ndërgjegjësimi është problemi i shoqërisë, kurse ndëshkim i është problemi i ligjit. Ne jemi ende në fazën kur besojmë se burgu është zgjidhja dhe jo shkolla. Kur themi ndërgjegjësimi, i pari është edukimi, që e kemi me aq mangësi, nga testet që dalin jashtë sallave të provimit çdo sezon, deri te mungesa e laboratorëve dhe leximi, pa të cilat shkolla nuk mund të kuptohet. Por a ka ndonjë debat publik se si duhet të jetë shkolla? Qeveria e Kuvendi heshtin. Profesorët po e po. Ata janë palë me pushtetin! Nuk ka të pavarësuar...

Ka një handikap shekullor, që nuk po tejkalohet, përpjekja e qeverisë për t’u identifikuar me popullin, vendin, kombin, atdheun, shqiptarët, diasporën, duke u paraqitur si shpëtimtare e tyre nga “rreziku” i opozitës: “ne s’-jemi më të mirët, por më të mirë se ne nuk ka”, “po erdhën ata – kundërshtarët, mbeten në mes të gjitha punët e nisura!” etj. Si baballarë të kombit janë hequr të gjithë sundimtarët me emra të frikshëm (fashistë, nazistë, komunistë) të shekullit XX, sigurisht që nuk jemi sot si atëherë, por autokracia është një pjellë e keqe e atyre regjimeve. Fatmirësisht bota Perëndimore ka gjithmonë shembuj madhorë të funksionimit të demokracisë, siç ishte dorëheqja e Presidentit Joe Biden nga kandidimi për një mandat të dytë presidencial, apo ndërrimi i qeverive, pa lëshuar “rrënjë” të përhershme, në Itali, Francë, Angli etj., ngaqë atje është kulti i shtetit dhe jo i individit që nuk di të shkulet nga posti. Nëse do të kishim politologë, filozofë, analistë të pakompromis të zhvillimeve tona politike, në qasje me ato ndërkombëtare, doemos që në publik do të kishte tjetër perceptim për politikëbërjen dhe qeverisjen ndër ne.

Problematika të mprehta ka plot, siç ka edhe profesionistë të zot, por nuk dimë, mbyllja në vetvete dhe mospërballa e tyre me mbrapshtitë e pushtetit vjen nga lodhja e mundimshme e tranzicionit, presioni i politikës, apo më keq akoma, nga “blerja” e heshtjes...

NDREK GJINI

BARONI IRLANDEZ QË REFUZOI TË BËHET MBRET I SHQIPËRISË

Irlandezi Rowland George Allanson-Winn, i njohur si Baroni i 5-të Headley (19 janar 1855 – 22 qershor 1935), refuzoi dy herë ofertën për t'u bërë Mbret i Shqipërisë.

Ky personalitet me një histori të pasur dhe të larmishme ishte një figurë e rëndësishme në historinë e komunitetit mysliman britanik. I lindur në Londër, Allanson-Winn u arsimua në Westminster School dhe më pas në Trinity College të Universitetit të Kembrixhit.

Ai më vonë ndoqi Middle Temple për studime juridike dhe e përfundoi shkollimin e tij në King's College, Londër. Megjithatë, më vonë ai vendosi të ndjekë një karrierë si inxhinier ndërtimi, duke ndërtuar rrugë në Indi dhe duke drejtuar projekte të rëndësishme infrastrukturore.

Allanson-Winn ishte gjithashtu një boksier i pasionuar dhe autor librash mbi boks. Në vitin 1899, ai u martua me Teresa Johnson, vajzën e William H. Johnson, ish-Vezir i Ladakhut në Indi. Teresa vdiq në vitin 1919, një humbje që ndikoi thellë në jetën e tij.

Jeta e tij mori një kthesë të papritur më 16 nëntor 1913. Allanson-Winn u konvertua në Islam dhe mori emrin Sheikh Rahmatullah al-Farooq.

Ai themeloi Shoqërinë Myslimane Britanike në vitin 1914 dhe shkroi disa libra mbi Islamin, përfshirë "Zgjidhjen Perëndimor në Islam" dhe

"Tre Profetët e Mëdhenj të Botës".

Ai kreu dy herë haxhin në Mekë, duke udhëtuar gjerësisht për të përhapur njohuritë e tij.

Në vitin 1913, pas vdekjes së kushëririt të tij, ai trashëgoi titullin si Baroni i 5-të Headley. Në vitin 1921, ai u martua me shkrimtarën australiane Barbara Baynton. Megjithatë, në vitin 1922, ai shpalli falimentimin në të gjitha bizneset e tij, duke kaluar në vështirësi financiare.

Pavarësisht nga problemet e tij financiare, fama e tij mbeti e lartë në qarqet e larta të shoqërisë.

Miq të tij në SHBA dhe Evropë lobuan për të, duke i ofruar dy herë fronin mbretëror të Shqipërisë në vitin 1925. Ofertat përfshinin një shpërblym prej 500,000 dollarësh dhe 50,000 dollarë në vit, të cilat ai i refuzoi.

Pas këtij refuzimi, gruaja e tij, Lady Headley, u kthye në Melburn, ku vdiq në vitin 1929.

Ai ishte një nga Baronët më të njohur në botë që u konvertua në Islam në Angli, shumë përpara se myslimanët të mbërrinin në numër të madh nga



India dhe Pakistani.

Ai ishte hoxhë dhe drejtues kryesor i xhamisë në qytetin Woking të Britanisë, një qytet me një trashëgimi të pasur arkitekturore dhe historike me Xhaminë Shah Jahan.

Xhamia Shah Jahan, e ndërtuar në vitin 1889, është një nga thesaret e mëdha arkitekturore të Wokingut dhe është njohur si xhamia e parë e ndërtuar në Britani.

Një nga hoxhallarët dhe drejtuesit më të hershëm të shquar të kësaj xhamie ishte Rowland George Allanson Al-

lanson-Winn, Baroni i 5-të Headley, që ishte dhe një nga Baronët e parë të konvertuar në Islam.

Baronia e Allanson-Winn, me origjinë nga Aghadoc në Kerry, Irlandë, daton që nga viti 1797. Në vitin 1913, pas vdekjes së kushëririt të tij, ai trashëgoi titullin dhe pasuritë e familjes në Kerry.

Në të njëjtin vit, ai u konvertua në Islam dhe mori emrin mysliman Sheikh Rahmatullah al-Farooq. Ai themeloi Shoqatën Myslimane Britanike në 1914, shkroi disa libra mbi Islamin dhe bëri dy herë haxhin në

Mekë.

Në vitin 1922, ai shpalli falimentimin. Një vit më vonë, ai refuzoi ofertën për t'u bërë Mbret i Shqipërisë, duke thënë se "e vetmja gjë që mund të përfitojë nga ai Fron Mbretëror janë telashet dhe ndofta mundësia që të vritej."

Baroni Headley vdiq më 22 qershor 1935 dhe u varros në Varrezën Brookwood, pranë Woking. Titulli Baron i familjes Headley u shua kur djali i tij më i vogël, Charles Allanson-Winn, vdiq në vitin 1994.



**NA GJENI NE FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dottech
website





BESNIK MUSTAJ

MAL BERISHA SJELL NJË BOTIM SUI GENERIS PËR OPUSIN E VEPRËS SË SIR NOEL MALCOLM PËR SHQIPTARËT

Libri ALBANIANADA/ SHQIPTARIADA është një botim sui generis. I kushtohet historianit britanik Sir Noel Malcolm. Por nuk ka asgjë të ngjashme me një biografi. Noel Malcolm ka tashmë një opus shumë të gjerë dhe të shtrirë në shumë fusha, të pranuar dhe të vlerësuar lart jo vetëm nga mjediset e akademikëve dhe të dijetarëve, por edhe nga opinioni i gjerë i lexuesve në anglisht dhe në dhjetëra gjuhët ku është përkthyer. Tri nga këto vepra kanë në qendër shqiptarët dhe historinë e tyre. Janë: “Kosova, një histori e shkurtër”, “Agjentë Perandorak” dhe “Shqiptarët, Rebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit”. Të tri këto vepra janë të botuara edhe në shqip dhe të çmuara. Ky botim përqendrohet kryesisht te këto tri vepra, por nuk është aspak një shqyrtim kritikist i vërtetësisë së fakteve të sjella nga autori dhe as i përfundimeve, në të cilat arrin ai me metodën e tij përmes këtyre fakteve.

Mirëfilli, ky botim është script-i i një filmi dokumentar me tri episode, realizuar nga ambasadori Mal Berisha, kushtuar Sir Noel Malcolm-it. Në të përfshihet një tekst i kursyer, shkruar nga autori me cilësinë e rrëfyesit të filmit, një numër do të thosha po ashtu i kursyer intervistash me protagonistin e veprës si dhe shumë dëshmi personalitetesh britanike dhe shqiptare, të cilët nuk janë të gjithë doemos miq të Sir Noel Malcolm-it në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, por njihen me të dhe më të shumtët kanë si arsye të njohjes me të pikërisht veprën e tij të jashtëzakonshme si historian dhe dijetar, për të cilin, Dr. David Shankland, drejtor i Institutit Mbretëror Antropologjik, Londër, thotë se ndër bashkëkohësit, është ai që afrohet më shumë me një gjeni në studimet historike moderne. Nuk më duket ndonjë teprim në lëvdatë nga ana e Dr. David Shankland. Edhe pse me fjalë të tjera, të njëjtin vlerësim kanë edhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë punim, të pyetur nga Mal Berisha. Është një përfundim, ku ata arrijnë në sajë të njohjes së gjerë të veprës madhore të Sir Noel Malcolm-it, shtu me këtë rast edhe njohjen ku më shumë e ku më pak nga afër të personalitetit të tij si njeri.

Ashtu si filmi dokumentar, edhe ky botim i drejtohet me përparësi publikut shqiptar. Rrjedhimisht, edhe autori Mal Berisha, qysh në koncept, do të përqendrohej kryesisht te tri veprat që Sir Noel Malcolm-i u ka kushtuar shqiptarëve dhe historisë së tyre. Në fjalën hyrëse, shkruar posaçërisht për këtë botim, ambasadori Mal



Berisha e ndien të nevojshme t'i përgjigjet pyetjes se çfarë e shtyu të bënte këtë film dokumentar. Dhe thotë:

“I bindur për vlerën e jashtëzakonshme të veprës së Sir Noel Malcolm-it për ne shqiptarët, mendova dhe besova se një film dokumentar për jetën dhe veprën e tij, e rrëfyer nga figura të shquara britanike, shqiptare, shqiptaro-britanike ose britaniko-shqiptare, ishte një detyrim dhe shprehje e mirënjohjes së thellë ndaj veprës së tij. Një dokumentar i tillë do të shërbente edhe për të forcuar marrëdhëniet e kombit tonë me Mbretërinë e Bashkuar”.

Mirënjohja është një virtut i spikatur në karakterin identitar të shqiptarit. Në këtë rast besoj se kjo mirënjohje bëhet edhe më komplekse nisur nga fakti se kush e shpreh atë.

Mal Berisha ka lënë tashmë emrin e tij të mirë në diplomacinë shqiptare. Përvoja në shërbimin e jashtëm e në mënyrë të veçantë koha e kaluar në drejtim të marrëdhënies të Shqipërisë me Mbretërinë e Bashkuar e ndihmon mjaftueshëm për ta përjetuar këtë mirënjohje ndaj Sir Noel Malcolm-it jo thjesht si një emocion fisnik, por shumë më gjerë: në këtë kontekst, mirënjohja e Mal Berishës është një përfundim krejt logjik, mbështetur në dhjetëra e dhjetëra fakte madhore, kur libri “Kosova, një histori e shkurtër”, për shembull, ka shërbyer në mënyrë vendimtare për përfshirjen e kancelarive politike të fuqive demokratike të botës së sotme në

zgjdhjen e njëjës dramatike të Kosovës duke sjellë çlirimin dhe pavarësinë e saj. Vetëdija prej ambasadori e shtyn Mal Berishën të besojë se, me këtë paraqitje të personalitetit të Sir Noel Malcolm-it, do të ndihmojë edhe në forcimin e marrëdhënies të kombit tonë me Mbretërinë e Bashkuar. Kësisoj, si një nga lexuesit në dorëshkrim të kësaj pune, mbetem i bindur se ambasador Mal Berisha përcjell në këtë rast mirënjohjen e një kombi të tërë në kuptimin më të lartë të kësaj fjale për Sir Noel Malcolm-in.

Duket si një mrekulli e Zotit domethënë e vështirë për t'u besuar që një libër, – në këtë rast “Kosova, një histori e shkurtër”, – ka patur ndikim vendimtar në ndryshimin e qasjes së kancelarive politike të fuqive të mëdha demokratike ndaj fatit të popullit të Kosovës. Mal Berisha ka gjetur njerëzit me personalitet të plotë, të cilët, duke e pohuar një fakt të tillë, i japin atij një mbështetje të pakundërshtueshme. Por edhe kaq, ndoshta, nuk do të mjaftonte për të bindur publikun e gjerë se kjo ka ndodhur para një çerek shekulli. Mal Berisha, si autor, e mban parasysh këtë rrezik. Ai nuk merr përsipër të na sjellë përmbledhtazi në punimin e tij faktet dhe argumentet e paraqitura në veprën e vet nga Sir Noel Malcolm-i, për të na treguar se ai ka nxjerrë në dritë të vërtetën historike. Mal Berisha kujdeset të skicojë profilin e historianit, i cili e bartë në publik këtë të vërtetë e që është Sir Noel Malcolm-i. Me sa duket, Mal Berisha nisat nga një urti e pleqve të vendlindjes së tij, sipas të cilës e vërteta ka sigurisht rëndësinë e vet,

por po kaq rëndësi ka edhe kush e shqipton atë. Kështu, ne zbulojmë edhe disa cilësi të vlera morale dhe intelektuale të personalitetit të Sir Noel Malcolm-it, të lidhura këto me arsyet, që e shtynë atë të ndërmerre një punë kaq të madhe e të vështirë, siç ishte ndriçimi i historisë së shqiptarëve.

Me pak fjalë, mbështetur te ky botim dhe te filmi dokumentar që i ka paraprirë, ne mësojmë se Sir Noel Malcolm-i është në natyrën e tij një burrë romantik, cilësi kjo që e ka frymëzuar gjithmonë për t'iu përkushtuar me pasion të vërtetave të harruara, të shërpfillura apo edhe më keq, të manipuluar nga historiografia dhe nga politika e mbrapshtë, duke sjellë pasojat dramatike për popujt apo bashkësitë njerëzore bartës të këtyre të vërtetave. I tillë është pa dyshim rasti i shqiptarëve në përgjithësi dhe i shqiptarëve të Kosovës në veçanti.

Sir Noel Malcolm e kishte dëshmuar tashmë me një sërë veprash madhore përpara publikut britanik dhe më gjerë integritetin e vet të pacënueshëm, ku kërkimi i të vërtetës ishte dhe mbetej një përkushtim i shenjtë, mbi të cilin ai nuk mund të shkelte për asnjë arsye. Sir Noel Malcolm-i është gjithashtu një burrë me shqisën e kureshtjes jashtëzakonisht të zhvilluar. Dëshmi e saj është edhe fakti se, ndër 23 gjuhët e huaja që njeh, është edhe shqipja. Kjo do t'i shërbente natyrisht si lehtësi shtesë në hulumtimet nëpër arkiva. Vazhdimi i punës për shkrimin do të ishte çështje metode, vullneti dhe aftësie për të analizuar, të cilat ai i kishte me tepri. Në fjalë të fundit, e vërteta

për shqiptarët, për rrënjët dhe për degët e tyre, që do të shprehte ai në afro 1600 faqet e botuara, do të ishte e besueshme për politikanët dhe për opinionin e gjerë publik jo vetëm pse ishte e vërtetë, por edhe se vinte prej penës së Sir Noel Malcolm-it.

Për ta mbyllur këtë shënim, do të nënvizoja edhe një aspekt tjetër, i cili më duket me shumë rëndësi për t'u mbajtur mend. Nisur nga fakti i pranuar se “Kosova, një histori e shkurtër” pati një ndikim pak a shumë jetik mbi vendimet e marra në kancelaritë e fuqive demokratike euro – atlantike në periudhën 1998 – 2007 lidhur me fatin e Kosovës, ne, shqiptarët në përgjithësi, duhet të nxitemi për ta shqyrtuar në mënyrë kritikiste një stereotip të ngulitur si në folklorin edhe në historiografinë tonë zyrtare, domethënë në kujtesën tonë kolektive kombëtare.

Është fjala për stereotipin, sipas të cilit, gjatë përplasjeve tona për mbi-jetesë, fuqitë e mëdha të kohës i kanë mbështetur fqinjët tanë grabitqarë për shkak të frymës së tyre apriori antishqiptare. Shembulli i ndikimit për mirë që pati libri i Sir Noel Malcolm-it në vendimet e marra në Londër, në Uashington, në Bruksel, në Paris apo në Berlin gjatë periudhës së lartpërmendur tregon se sjelljet, domethënë anësitë këtyre fuqive janë shumë shpesh pasojë e mosnjohjes së të vërtetës së shqiptarëve në këto kryeqytete. Një shqyrtim i tillë kritikist i stereotipit në fjalë do të na çlironte disi nga kompleksi i rëndë i viktimës.

Rreth 50 mijë shtetas shqiptarë morën nën-shtetësinë e një vendi të Bashkimit Europian gjatë vitit 2022 duke u renditur të tretët në Evropë pas marokenëve dhe sirianëve, thuhet në raportin e publikuar nga Agjencia Europiane e Statistikave, "Eurostat" dhe Rrjetit Europian për Migrimin. Dy vendet fqinje me Shqipërinë, të njohura tre dekadat e fundit dhe për emigrimin e lartë të shqiptarëve, Italia dhe Greqia janë kryesoret në Evropë për numrin e lartë të lëshimit të nështetësive për shtetasit shqiptarë.

Ndërsa referuar të dhënave të Eurostat-it, për pesë vitet e fundit mbi 213 mijë shqiptarë fituan shtetësinë një një vend të Bashkimit Europian. Sipas raportit vjetor mbi migrimin dhe

azilin në Europë, 6920 shqiptarë aplikuan për herë të parë për azil gjatë vitit 2023 në një vend të Bashkimit Europian.

Shqiptarët kryesojnë në vitin 2023 listën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për nga numri i azilkërkesve në Europë dhe renditen edhe të pestët në Europë pas turqve, gjeorgjianëve, rusëve dhe ukrainasve. Ndërkohë, sipas raportit shtetasit shqiptarë renditen të dytët në Europë pas ukrainasve për nga numri i refuzimeve të hyrjes në një vend të Bashkimit Europian gjatë vitit 2023.

Rreth 13855 shtetas shqiptarë që përbëjnë 11.6% të refuzimeve pasojnë rreth 18330 shtetas nga Ukraina, që iu refuzua hyrja në një vend të Bashkimit Europian vitin e

MBI 213 MIJË SHQIPTARË MORËN SHTETËSINË E NJË VENDI TË BE-SË NË 5 VITET E FUNDIT

shkuar.

Sipas raportit shqiptarët renditen të dytët pas gjeorgjianëve edhe për numrin e lartë të kthimeve vullnetare apo të detyruara nga një vend europian në një vend të tretë gjatë viti 2023.

Sipas raportit 7870 shtetas shqiptarë që përbëjnë 8.5% të kthimeve pasojnë 10 390 gjeorgjianë që kryesojnë listën e vendeve për kthimet e detyruara të migrantëve jo të rregullt nga vendet europiane.

Ndërkohë raporti për migrimin dhe azilin thotë se rreth 76 mijë shqiptarë janë evidentuar në marrjen e lejeve të reja apo të një statusi ligjor të qëndrimit gjatë vitit 2023 në vendet e Bashkimit Europian. Raporti nuk përfshin migrimin e shqiptarëve drejt Britanisë së Madhe që doli nga Bashkimi Europian.

Vetëm gjatë vitit 2022 sipas autoriteteve britanike 12658 emigrantë nga Shqipëria u

futën në mënyrë të parregullt në Britaninë e Madhe kryesisht nga Kanali La Manshit me varka të vogla.

Të dhënat britanike për periudhën shtator 2022 – shtator 2023, tregojnë se Britania e Madhe përjetoi një rritje të konsiderueshme në kthimet e detyruara të shtetasve të huaj që arritën në 5,506 persona, nga të cilët shqiptarë, përbëjnë mbi gjysmën (52%) të kthimeve të detyruara./VOA/

JANUSZ BUGAJSKI

Kremlini i Putinit po shfaq gjithnjë e më shumë shenja frike për sa i përket luftës së tij kundër Ukrainës, për shkak të intensifikimit të presioneve ushtarake, ekonomike dhe ndërkombëtare. Moskë është e shqetësuar se një Ukrainë plotësisht e armatosur do të përfshihet në një ofensivë të suksesshme për të rimarrë pjesë të mëdha të territorit të saj dhe për të dëbuar forcat pushtuese ruse.

Propozimet absurde të Putinit për dorëzimin e Ukrainës në prag të samitit të paqes të qershorit në Zvicër tregojnë se Moskës po i mbarojnë idetë në parandalimin e Perëndimit të pajisë plotësisht forcat e armatosura të Ukrainës.

Ushtria ruse nuk ia doli të pushtonte ndonjë territor të rëndësishëm, gjatë gjashtë muajve që Kiev kishte një mungesë rrezikuese predhash, për shkak të vonësive në financim nga ShBA-ja. Dhe, gjatë javëve të fundit, Moskë që e paafte të përparonte në rajonin e Harkivit, pavarësisht avantazhit të saj në numër.

Tani që, më në fund, Kievit iu lejua të godasë në territorin rus me armë perëndimore, infrastruktura ushtarake e Moskës është shënjestër e sulmeve të përditshme. Këtu përfshihen furnizueset me karburant, mbrojtja ajrore, rezervat e armëve, si dhe terminale rrugore dhe hekurudhore.

Gjasat janë që Ukrainës t'i sigurohen jo vetëm armë me rreze më të gjatë veprimi, por edhe skuadrilje aeroplanësh luftarakë F-16, me çfarë do dëmtonte edhe më fort forcat tokësore të Rosisë.

Edhe pse Moskë e ka rritur prodhimin e mjeteve ushtarake, ajo nuk mundet ta kompensojë humbjen masive të tankeve, artilerisë, sistemeve të mbrojtjes ajrore dhe pajisjeve të tjera.

Përdorimi i tankeve të mbajtura në magazinë që nga vitet 1970 shpreh qartë cilësinë e ulët të pajisjeve ruse në përdorim. Sipas raportimeve të inteligjencës perëndimore, mbi gjysmë milioni trupa ruse janë vrarë, plagosur ose kapur rob dhe numrat e tyre po rriten me shpejtësi, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e trupave të saj të oficerëve janë asgjësuar.

Gjithnjë e më shumë, Moskë po mbështetet në rekrutimin e emigrantëve dhe mercenarëve të huaj nga Azia Qendrore, Amerika Latine, Afrika dhe Lindja e Mesme. Ata joshen me premtime për paga të larta, por këta rekrutë të trajnuar mezi arrijnë të qëndrojnë për pak ditë në front të luftës.

Meqë forcat ushtarake të Rosisë vijojnë të bien në luftë, Moskës mund t'i duhet të ndërmarrë mobilizim masiv, një lëvizje shumë e papëlqyeshme në popull të cilën Kremlini e ka shmangur nga frika se mos shkaktonte një tjetër rrjedhje të madhe të rinjve jashtë vendit, si dhe provokonte trazira sociale e rebelime ushtarake.

Putini ka zbuluar se sanksionet ndërkombëtare kanë pasur më shumë ndikim sesa është pranuar nga zyrtarët e tij. Ai kërkoi që ato të hiqen, për mundësinë e ndonjë marrëveshje paqeje me Ukrainën.

ÇFARË KA ZBULUAR PUTINI?



Sanksionet e kanë ulur në vijimësi qasjen e Rosisë në teknologjinë, pajisjet dhe softuerin e huaj. Uashingtoni gjithashtu ka filluar ta vështirësojë shmangien e sanksioneve prej vendeve të treta që ofrojnë komponentë për luftën e tij. Bankat ruse kanë frikë nga tërheqjet masive bankare, pasi qytetarët kanë frikë se do të humbnin kursimet e veta. Kostoja e jetesës, gjithashtu, po rritet duke rezultuar në inflacion domethënës, ulje të shërbimeve sociale dhe mungesë produktesh të caktuara.

Për sa i përket të ardhurave, kompania e madhe ruse e energjisë Gazprom po shkon drejt falimentimit, pasi shitjet e gazit natyror në Evropë kanë rënë ndjeshëm. Industria e eksportit të qymyrit gjithashtu është në prag të kolapsit financiar. Nafta bruto e Rosisë shitet me çmime nën mesataren globale dhe eksportet e naftës

së rafinuar janë në rënie. Sanksionet me të rënda të Perëndimit do ta kufizojnë tregtinë e naftës dhe të gazit natyror rus. NATO planifikon të vërë nën kontroll lëvizjen e cisternave të naftës të vendeve të treta që transportojnë eksporte ruse përmes ujërave evropiane.

Duke ndaluar këtë flotë në hije që lundron nëpër ngushticat daneze, Moskë do të humbasë rreth një të tretën e eksporteve të saj të naftës në rrugë detare. Që kur qeveritë perëndimore vendosën një çmim kufi për naftën ruse, Moskë është mbështetur në një flotë cisternash të vjetruara të bazuara dhe të siguruar jashtë Perëndimit. Lëvizjet për të bllokuar këto anije do t'i ulnin ndjeshëm të ardhurat e Kremlinit.

Për sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare, agresioni i Moskës ndaj Ukrainës i ka hapur rrugën zgjerimit të NATO-s me

pranimin e Finlandës dhe Suedisë, ka forcuar praninë ushtarake të NATO-s përgjatë frontit lindor dhe ka nxitur të gjitha vendet të shtojnë shpenzimet e tyre për mbrojtje, të blejnë armë të reja dhe të rrisin numrat e forcave të armatosura.

Prania ushtarake e ShBA-së gjithashtu po rritet, veçanërisht në Poloni, ku tashmë ndodhen mbi 10 mijë trupa amerikane. Përgatitjet po avancojnë për t'iu kundërpërgjigjur çdo tentative sulmi nga ana e Rosisë ndaj ndonjë anëtarit të NATO-s.

Kufiri midis Rosisë dhe NATO-s është bërë shumë më i gjatë pas përfshirjes së Finlandës në Aleancë, ndërsa përqendrimi i forcave ruse përgjatë këtij kufiri është i ulët, pasi pjesa më e madhe e burimeve të saj të luftës dhe forcave të armatosura janë vendosur në vijën e frontit me Ukrainën.

Në të njëjtën kohë, Kina po përfiton nga dobësia e Rosisë duke këmbëngulur për naftë dhe gaz me çmime të ulëta dhe duke lidhur me Moskën marrëveshje ekonomike nga të cilat kryesisht do të përfitojë Kina.

Në fakt, Rusia po kthehet në një vasal të Kinës. Laku rreth qafës së Putinit po shtrëngohet dhe mund të priten beteja të tjera të brendshme për pushtet, ndërsa Rusia vërvitet drejt kolapsit. /Gazeta "Dita"/



NA GJENI NE FACEBOOK
KERKO THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES



Akoma nuk keni Website?

PROFESSIONAL

AKOMA NUK JENI TË REGJISTRUAR NE GOOGLE?

ADRESA E ZYRAVE

30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT



Responsive Website

Custom Website Design

Redesign Website

Web Development

Mobile App Design

E-commerce Solutions

KONTAKTONI



020 7018 7929



073 4066 5946

VETON SURROI

STINË E JOMËRZITSHME PËR NË OLIMP

1. Kosova (me gjithë modestinë e vogëlsisë së saj) gjendej aty ku janë Franca dhe SHBA sot- të votojnë për të penguar që të fitojnë pushtet kundërshtarët e demokracisë liberale. Mësimi për të gjithë është se pengimi i ardhjes së kundërshtarëve në pushtet është shumë i rëndësishëm, por jo edhe i mjaftueshëm.

1. Një herë dhe moti në kontekstin e dinamikës historike, do të ketë qenë viti 1993, një taksist në Londër më shpejgoi pse nuk ndihet evropian me konstatimin e thjeshtë gjeografik se është qytetar i Britanisë së Madhe, që është një ishull, ndërsa që Evropa është një "mainland" që është territor fqinj i këtij ishulli. Taksisti nuk ishte konservator, për më tepër kishte vetëm fjalë të këqija për këtë parti, por në mendjen e tij ky do të kishte qenë sentiment i përgjithshëm i britanikëve- një i veçantisë-që karakterizon këtë vend dhe kombet e ndryshme që e përbëjnë.

Më ra në mend ky përkujtim i taksistit mbi 30 vjet më pas, ndërsa përfunduan zgjedhjet në Britani të Madhe dhe Partia laburiste shënoi fitore mbresëlënëse me të cilën zëvendësoi pushtetin e konservatorëve të 14 vjetëve të kaluar.

Në Britaninë e Madhe kjo mund të duket gjë e zakonshme- herë merr pushtetin Partia konservatore e herë ajo Laburiste -një stabilitet i demokracisë liberale në të cilin rotacioni i pushtetit bëhet me një gotë shampanje a birre natën e shpalljes së rezultateve dhe me mbledhjen e parë të qeverisë së re një ditë më pas.

Në këtë vit, kur mbahen zgjedhjet në gati gjysmën e botës më duket se Britanisë së Madhe i përket përshkrimi global i taksistit, një ishull i demokracisë liberale. Zgjedhjet e Britanisë së Madhe mund të kenë sjellë të majtën në pushtet pas 14 vjetësh, por kjo është e majtë tradicionale, që merr pushtetin prej të djathtës tradicionale. Një ndryshim, brenda traditës.

2.

Në këso përshkrimi Britania e Madhe më duket si qendra gravitacionale e demokracisë liberale në botën transatlantike. Përtej Oqeanit, në SHBA zhvillohet një garë tjetër politike, siç u bë gjatë javëve të fundit në anën tjetër të Kanalit të Lamanshit. Ka diçka të përbashkët në këto dy gara, në SHBA dhe Francë, e ajo është nevoja mobilizuese për të qenë kundër rreziqeve- në këso rasti të rreziqeve për demokracinë liberale. Në SHBA gara e sotme nuk është se kush nga kandidatët do ta bëjë këtë apo atë veprim ekonomik e këtë apo atë qëndrim gjeopolitik. Gara në SHBA është reduktuar në atë se si të pengohet ardhja në pushtet e Donald



Trumpit, një njeriu i cili është shpërfillës i demokracisë liberale. Gara në Francë për parlamentin e vendit në rundin e dytë të sistemit të veçantë zgjedhor francez, nuk ishte e ndonjë oferte të veçantë ideologjike, ishte ajo e "kordonit sanitar" për ta penguar ardhjen në pushtet të së djathtës së skajshme, të identifikuar tradicionalisht me emrin LePen.

Zgjedhjet në Francë treguan se mund të ndalet e djathta e skajshme- ajo mbeti në vend të tretë-por po ashtu treguan se të jesh kundër nuk mjafton për të qeverisur. Në javët e ardhshme Franca duhet të formojë një qeveri e cila do të duhet të tregojë një sens tjetër ekzistence, pos të qenit kundër së djathtës së skajshme.

Dhe në SHBA, javët e ardhshme duhet të tregojnë se si saktësisht mund të pengohet ardhja e Donald Trumpit në presidencë: me apo pa Joe Bidenin si kundërkandidat.

3.

Nga perspektiva e Kosovës, përvoja e këtij zhvillimi ku Britania e Madhe, qoftë edhe përkohësisht, është shndër-

ruar në qendër gravitacionale transatlantike e të tjerët po përpiqen ta zënë, ka disa pika prekëse. E para dhe pothuajse automatike është se Britania e Madhe është vend i cili është spikatur me angazhimin për pengimin e gjenocidit, çlirimin e Kosovës dhe shtetndërtimin e saj. Ç'është e vërteta kjo ka qenë politikë edhe e Partisë konservatore e cila është spikatur në rolin udhëheqës për mbrojtjen e Ukrainës e të Evropës në tërësi nga ndikimi negativ rus. Megjithatë, një mandat i fortë për Laburistët dhe politikën e tyre të afrimit me fuqitë e tjera evropiane e bën atë sërish një shtyllë të fortë trans-atlantike e cila meriton më shumë ndikim në kontinentin evropian. Dhe, po, do të ketë më shumë Britani të madhe në Evropë, rrjedhimisht edhe në Kosovë.

Por dy jehonat e tjera janë interesante sa për punë analize zgjedhore ashtu edhe për të tërhequr paralele ardhmërie.

Kosova ishte në dilemën e ngjashme politike në çfarë gjenden Franca e SHBA. Në zgjedhjet e kaluara, një numër i madh votuesish doli për të

kundërshtuar pushtetet korruptive, të kapjes së shtetit, të dhunës politike e të jokompetencës së plotë pos në hajni. Zgjedhjet e kaluara krijuan një pushtet të duarve të pastra, por jo domosdoshmërisht një pushtet në të cilin ato duar të pastra dëshmojnë aftësi për të hyrë në punë në sektorë të ndryshëm jete.

Nëse shërben për diçka si mësim që mund t'u japim francezëve është se edhe pas fitores kundër atyre që nuk i duam në pushtet (kapësve të shtetit, hajnave apo të djathtës së skajshme) nuk do të thotë se automatikisht e kemi kaluar lumin drejt një qeverisjeje efikase.

Dhe, po ashtu, nëse ka diçka që mund të krijojë paralele, është se në të konsumuar mandatin e fituar duke kundërshtuar hajnat, kapësit e shtetit apo përfaqësuesit e të djathtës së skajshme (si Trump apo LePen), do ndërton një narracion të ri, një ofertë të re.

4.

Nëse do thjeshtësuar në vija të trasha këtë rrëfim zgjedhjesh atëbotë ai do të

dukut kështu. Gati gjysma e botës do të votojë më 2024. Në vende si Meksika u zgjodh për herë të parë një grua (hebreje, shkencëtare) presidente, e në Iran një figurë reformatore-me rëndësi për demokracinë si të tillë, me jo ndonjë konsekuencë të drejtpërdrejtë për Kosovën. Në vendet e BE-së gëzimi do të jetë nga fakti se e djathta e skajshme nuk fitoi aq sa mendohej a presupozohej, dhe e njëjta gjë ndodhi në Francë.

Në botën e cila ka ndikim mbi jetën e kosovarëve dhe shqiptarëve në përgjithësi, atë transatlantike, gëzimi i përgjithshëm do të jetë nëse nuk fitojnë Trump, Orban, Le Pen dhe pjesëtarë të kësaj shoqërie. Në radhë të dytë, pastaj do të vijë pyetja se kush fitoi në vend të tyre.

Kosova, vend i çudirave, është një cikël zgjedhor përpara atyre të botës transatlantike, dhe pyetja të cilën partitë politike duhet ta bëjnë përpara elektoratit në zgjedhjet që do të vijin kur të përfundojnë këto të gjysmës së botës, është jo kundër çkahit duhet të votojnë qytetarët e vendit, por për çka konkretisht duhet të votojnë.

FINANCIAL TIMES

SERBIA, VENDI EVROPIAN QË LUAN ME SHBA-NË, RUSINË, KINËN DHE EVROPËN

Për 25 vjet, një kryqëzim i ngarkuar në qendër të kryeqytetit serb të Beogradit, dominohej nga ndërtesa e dëmtuar e Ministrisë së Mbrojtjes së ish-Jugosllavisë. U la qëllimisht ashtu siç ishte, qëkur gjatë luftës në Kosovë bombat e NATO-s e shkatërruan atë në vitin 1999.

Megjithatë, kjo faltore e nacionalizmit serb, tani do të shembet dhe do të shndërrohet në kompleks atraktiv hotelesh dhe apartamentesh. Investitorët mbi të gjitha janë nga Amerika – nga kundërshtari i vjetër i Beogradit, i cili dy herë në vitet 1990 udhëhoqi ndërhyrjet ushtarake të NATO-s për të penguar agresionin serb në rajon.

Dhe, këta nuk janë financierë të rëndomtë amerikanë. Jared Kushner, dhëndri dhe ish-këshilltari i lartë i Donald Trumpit, kryeson Affinity Partners-in, fondin e investimeve që qëndron prapa marrëveshjes, ndërsa Richard Grenelli, ndihmësi i shquar i ish-administratës Trump i cili mban lidhje të ngushta me ish-presidentin, ndihmoi për të ndërmjetësuar.

Analistët thonë se marrëveshja është rast studimi se si një shtet i vogël i painkuadruar mund të përgatitet për kthimin e mundshëm të Trumpit në Shtëpinë e Bardhë. Gjithashtu pasqyron fokusin e shtuar përëndimor ndaj Serbisë, në kohën kur prioritet është bërë largimi i saj nga shpirti historik binjak – nga Rusia.

Aleksandar Vuçiqi, president i Serbisë që nga viti 2017, këmbëngul se marrëveshja është ndërmarrje tërësisht biznesore dhe hedh poshtë idenë për quid pro quo [këmbim favoresh]. “Jam shumë krenar për këtë”, thotë ai për Financial Times. “Kjo do të sjell më shumë investitorë dhe më shumë njerëz në Beograd. Pastaj do të kemi një hotel Trump, një hotel Ritz-Carlton... Shumë shpejt do të kemi gjithçka. Ishin shumë profesionalë ata njerëz të cilët negocionin në emër të amerikanëve. Kërkesat e tyre nuk ishin të lehta”.

Por, po ashtu, marrëveshja duket ashikare si politike; në fund të fundit, pala tjetër është shteti serb. Kjo bën me dije se Vuçiqi do të ketë lidhje të ngushtë me Shtëpinë e Bardhë në rast të fitores së shokut të tij populist nacionalist, Trump, në zgjedhjet e nëntorit në ShBA.

Grenelli, aleat i hapur – për të mos thënë luftarak – i Trumpit, i cili është konsideruar si sekretar i mundshëm i Shtetit nëse ish-presidenti e fiton mandatin e dytë, për herë të parë idenë e investimit të tillë në Beograd e hodhi në kohën kur ishte i dërguari i Trumpit për Ballkanin.

Sipas njerëzve të përfshirë në marrëveshje, kjo ndërlikohet me një vizion më të gjerë të inkurajimit të investimeve amerikane në Serbi, në tentimin për ta lidhur atë me sferën e influencës së Perëndimit dhe për të



dobësuar marrëdhëniet e saj të vjetra me Rusinë. Grenelli pëlqen ta paraqesë atë si mënyrë për të ndihmuar që marrëdhëniet ShBA-Serbi të lëvizin nga e kaluara, sipas mënyrës së investimeve amerikane të pasvitetit 1945 ndaj Tokios.

“Besoje se kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm në tërheqjen e Serbisë nga ndikimi i Rusisë dhe i Kinës dhe për të qenë më afër ShBA-së”, tha ai për FT. “E pranoj gjithashtu se duhet bërë më shumë dhe jam i përkushtuar që pikërisht këtë ta bëj”.

Për të parandaluar kritikën ndaj kësaj marrëveshjeje nga lobi i fuqishëm nacionalist serb i krahut të djathtë, i cili është fuqimisht pro Moskës, investitorët janë zotuar që në një lokacion të ndërtojnë një memorial për viktimat e bombardimeve të NATO-s – në konsultim me arkitektët serbë.

Njëkohësisht, Kushneri planifikon të investojë në një projekt luksoz turistik në Shqipërinë e afërt, për qejfin e kryeministrit të saj, Edi Rama. “Kemi nevojë për luks ashtu si shkretëtira ka nevojë për ujë”, thotë Rama, duke shtuar se Kushneri dhe Grenelli uverturën e bënë në Shqipëri, përpara se të shkonin për të investuar në Serbi. I vetmi ndryshim, shton ai, është se në Shqipëri ishte Kushneri e jo Grenelli ai i cili e bëri hapin fillestar. “Në Serbi sigurisht që Grenelli ishte prezantues, por këtu jo”, thotë Rama.

Në Uashington, njoftimi i marrëveshjeve ngriti pikëpyetjen mbi një konflikt të mundshëm interesi nëse Trumpi kthehet në detyrë. Grenelli dhe Kushneri e kanë hedhur këtë poshtë, duke argumentuar se po vepronjë si qytetarë privatë. Kushneri ka thënë se në rast të një mandati të dytë të Trumpit, ai nuk do të ketë rol në administratë.

Në Evropë, marrëveshja e Beogradit shihet si manovër klasike e mbrojtjes së mbijetesës së 54-vjeçarit Vuçiq, i cili për një dekadë ka dominuar në

politikën e brendshme dhe rajonale – për tre vjet si kryeministër i Serbisë dhe më pas për shtatë vjet si president – dhe të cilit i pëlqen të mbajë Amerikën dhe BE-në në përbalje ndaj Rusisë dhe Kinës.

“Është lojtar i mprehtë i shahut”, thotë Milan Antonijević, avokat serb dhe ekspert i të drejtave të njeriut i cili e portretizon Vuçiqin se po përpiket të ndjek një kurs të mesëm që i përshatet më së miri interesave afatgjata të Serbisë në botën gjithnjë e më shumëpolare. “Dhe, ai e di që ne nuk kemi aq shumë lojtarë në tabelën globale të shahut”.

Vuçiqi e ka një tabelë të vërtetë shahu, me kohëmatës, në bibliotekën e vet. Nëse do të përshkruhej si figurë, ai me siguri do të ishte oficer që bën zigzage në të gjithë tabelën. Në intervistën e FT-së, epokën aktuale të fluksit global e paraqet si kohë të dhe pasur me potencial – edhe pse me rrezik – për Serbinë.

Edhe teksa punonte me aleatët e Trumpit – dhe gjithnjë e më ngushtë me administratën e Bidenit – Vuçiqi për investime ka zhvilluar marrëdhënie edhe me rivalin e fuqisë së madhe të Amerikës, me Kinën. Gjithashtu e ka ruajtur lidhjen sentimentale të Serbisë me Moskën, megjithëse kryesisht nëpërmjet duarve të zgjatura dhe duke e mbajtur në distancë presidentin e Rusisë, Vladimir Putin. Nacionalistët serbë, një forcë e fuqishme në politikën e brendshme, e shohin Rusinë si shpirtin binjak sllav.

Serbët kanë dashuri “të kalkular” për Kinën, thotë Sërxfan Bogosavleviq, anketuesi kryesor i Serbisë, si dhe një dashuri “irracionale” për Rusinë. Prandaj, Serbia është një nga vetëm dy vendet evropiane – tjetri është shteti i Bjellorusisë – që nuk mbështet

sanksionet kundër Rusisë. Sa i përket Pekinit, Serbia dhe Hungaria ishin dy vendet e vetme evropiane të cilat presidenti i Kinës, Xi Jinping, i vizitoi në maj pas vizitës së tij shtetërore në Francë. Kina ka investuar shumë dhe shpeshherë kryeson në sondazhet e opinionit serb si fuqia më popullore e huaj.

E, megjithatë, në të njëjtën kohë Vuçiqi ka nxitur lidhjet me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, dhe po vepron të punojë me BE-në për të ndihmuar në zhvillimin e minierës më të madhe të litiumit në Evropë, në Serbinë perëndimore, në një projekt prej shumë miliardë eurove. Vuçiqi këmbëngul se qëllimi i tij është anëtarësimi në BE, që është partneri kryesor tregtar i Serbisë. Ka qenë kandidati për 12 vjet, por ka bërë pak përparime në tejkalimin e shqetësimeve të BE-së për përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit dhe mbi statusin e pazgjidhur të ish-krahinës së Kosovës.

“Vuçiqi ka politikë të gjithanshme”, thotë Ivan Vejvoda, bashkëpunëtor në Institutin e Shkencave Humane në Vjenë. “Në një moment e keni Xinë për vizitë. Pastaj... disa ditë më vonë, vijnë Zelenska [zonja e parë e Ukrainës] dhe Dmytro Kuleba [ministri i Jashtëm i Ukrainës]. Pastaj shkon në Qendrën Kulturorë Ruse dhe mban një fjalim revizionist. Dhe, më pas, dy ditë më vonë, ai është me BE-në duke folur për planet e zhvillimit”.

I pyetur nëse beson te BE-ja, Vuçiqi e anashkalon pyetjen. “Nuk jam dikush që do ta mbroj apo do ta sulmoj atë”, thotë ai. “Kur shihni se njerëzit janë shumë të zjarrtë për ta sulmuar BE-në, nuk bashkohem me ata sepse ata njerëz nuk janë racionalë. Por, kur e shoh histerinë për të ashtuqajturat vlera të BE-së, unë të njëjtën gjë e

bëj”.

Ka shumë mendime për BE-në, thotë ai. “Nëse shkon në takime [të BE-së], aty do të jetë një tubim i madh pro-ukrainas. Nëse dikush nuk thotë atë që të gjithë presin, perceptohet thuasë është ndërhyrës... Askush nuk dëshiron të dëgjojë mendime të ndryshme”.

Megjithatë, ai gjithashtu tregon se kur kreu i një shteti anëtar në BRICS – grupi i fuqive në zhvillim, të udhëhequra nga Brazili, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut – sugjeroi që ai të bashkohej me arsyetimin se Perëndimi po zbehet, ai e hodhi poshtë ofertën. “I thashë se jemi në rrugën tonë drejt BE-së”.

Për fuqitë perëndimore, pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia e bëri prioritet afrimin me Vuçiqin, mes shqetësimeve të vazhdueshme se Moska mund të përpiket të nxisë armiqësi në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovën fqinje të cilat kanë pakica të trazuara serbe.

Diplomatët perëndimorë dhe analistët rajonalë besojnë se ai po anon kah Perëndimi. Në intervistën e tij në FT e paraqet qëndrimin e tij kundër sanksioneve, si rrjedhojë e neverisë ndaj sanksioneve – pas vendosjes së tyre kundër Serbisë gjatë luftërave ballkanike të viteve 1990. Ai gjithashtu konfirmon se në mënyrë diskrete e ka ndihmuar Kievin, duke ua shitur municionet palëve të treta e të cilat pastaj përfundojnë te forcat e armatosura të Ukrainës.

“Vuçiqi nuk është as përfaqësues rus dhe as Putin i vogël, siç portretizohet ndonjëherë”, thotë Vejvoda. “A e duan shumica e serbëve Putinin? Po. A e duan Rusinë? Po. Por, kur pyeten se ku doni të udhëtoni, ata të gjithë duan të shkojnë në Evropën Perëndimore”.

Vuçiqi mund të përshkruhet më së miri si kameleon. E nisi karrierën në politikë si nacionalist ekstrem dhe ndërkohë që ka hyrë në qendër, ai ende rregullisht luan me kartën nacionaliste për të ruajtur mbështetjen e së djathtës – së fundi duke organizuar një takim pan-serb në Beograd. Për kritikë e tij, ai është paksa i ndryshëm nga Viktor Orbani, nga kryeministri joliberal hungarez i cili është tifoz i Trumpit dhe i cili përdhos qëndrimin e BE-së dhe të NATO-s ndaj Ukrainës.

“Ai [Vuçiqi] e ka korruptuar shtetin”, thotë Dragan Xhilas, themelues dhe udhëheqës i Partisë për Liri dhe Drejtësi – partia më e madhe opozitare e Serbisë. “Prokurorët, për shembull, janë zibidi, totalisht të politizuar. Vuçiqi nuk është i popullarizuar në Beograd, por e kupton se nacionalizmi është mënyra numër një për të mbetur në pushtet”.

Megjithatë, në të njëjtën kohë ka krijuar miqësi me Alex Sorosin, investitorin dhe filantropin i cili drejton bordin e Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur të themeluar nga babai i tij

BIRN: VOTUESIT JASHTË SHQIPËRISË PËRBALLEN ME RRUGË TË PËRPRJETË PËR TË DREJTËN E VOTËS! SI DO TË BËHET REGJISTRIMI I TYRE NË ZGJEDHJE

BIRN

Dy partitë kryesore politike shqiptare, Partia Socialiste në Pushtet dhe Partia Demokratike në opozitë, duket se kanë dakord në bisedimet e zhvilluara pas dyerve të mbyllura për të lejuar votimin në distancë të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë, por modalitetet e fitimit të të drejtës për të votuar në distancë janë të tilla që e bëjnë të vështirë ushtrimin real të votës nga emigrantët.

Dokumenti i dakordësuar mes palëve i rrjedhur në media, tregon se, ndryshe nga shtetasit rezidentë, të cilët në sistemin ligjor shqiptar prej të gjitha kohërave gëzojnë automatikisht të drejtën e votës për nga cilësia e të qenit shtetas, emigrantët, nëse do të duan të hedhin votë në distancë dhe jo duke u paraqitur personalisht në Shqipëri, do të duhet të bëjnë një regjistrim të veçantë në një regjistër të veçantë, ku regjistrimi do të jetë i vlefshëm vetëm për një palë zgjedhjeje.

“Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit,” thuhet në pro-



jektligjin e propozuar për të cilën palët kanë rënë dakord në nivel ekspertësh ndërsa diskutimet në nivel politik vazhdojnë.

“Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rish-tazi për çdo palë zgjedhje,” shkruhet më tej.

Emigrantët që vendosin të ushtrojnë të drejtën e votës në këtë mënyrë, paguajnë në mënyrë indirekte ç-regjistrim automatik dhe humbje të së drejtës së votës si shtetas rezidentë. Projektligji duket se ka lënë pa përmendur nevojën për rikthimin e kë-

tyre shtetasve të regjistri i votuesve rezidentë pas zgjedhjeve, nëse ata vendosin të rikthehen në atdhe ndonjëherë.

“Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij neni, ç’regjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit,” shkruhet më tej në projektligji.

E drejta e emigrantëve për të votuar pavarësisht se nuk janë të pranishëm në atdhe ditën e votimit është debatuar gjerësisht gjatë dekadës së fundit ndërsa një vendim i Gjykatës

Kushtetuese i ka kërkuar parlamentit të marrë masa për ta mundësuar këtë të drejtë. Procedurat e caktuara nga palët duket se i vendosin shqiptarët që jetojnë jashtë vendit në disavantazh duke i detyruar ata të regjistrohen me kërkesë për të fituar të drejtën e votës, ndryshe sistemi ligjor historik i vendit, në të cilin, e drejta e votës vjen automatikisht pa pasur nevojë për regjistrim paraprak.

Palët politike gjithsesi i kanë dhënë të drejtë vetes që të ndërhyjnë më tej në proces me kufizime të tjera të mundshme, gjatë shqyrtimit në të ashtuquajturin “institucion rregullator”.

“Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet me vendim të Rregullatorit,” shkruhet në propozim.

“Rregullatori” është një institucion i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që përbëhet nga anëtarë të votuar nga Kuvendi i Shqipërisë sipas preferencave të palëve politike. Ky institucion është ai që do të ketë të drejtë të hartojë “listën e detajuar të dokumentacionit”. Kriteret e hartimit të listës në fjalë të dokumentacionit do të përcaktojnë me gjasa se sa e lehtë ose sa e vështirë do të jetë për popullsinë jorezidente që të votojë.

Diskriminimi i shtetasve jorezidentë

përkundrejt atyre rezidentë, duke i kërkuar të parëve regjistrim me kërkesë për të marrë pjesë në zgjedhje ka gjasa që do të përbëjë një çështje për diskutim në vijim.

Aktualisht gati gjysma e popullsisë prej 4.6 milionë shtetas duket se jeton në emigrim. Emigrantët e kanë të drejtën e votës, por për ta ushtruar atë, deri më sot do të duhet të udhëtojnë drejt vendbanimit ku kanë regjistruar civil ditën e zgjedhjeve, gjë që shumica nuk e bëjnë.

Dhënia e të drejtës së votës në distancë, një praktikë e njohur në shumë vende të botës, është diskutuar si një opion për të demokratizuar vendin, nën supozimin që emigrantët nuk janë nën presionin e partive politike, kryesisht partisë në pushtet, siç janë banorët rezidentë. Por shumë ngrënë pikëpyetje nëse një shtetas që jeton prej vitesh në emigrim është apo jo e arsyeshme që të votojë për të zgjedhur qeverinë e vendit ku nuk jeton, por që do të qeverisë shtetasit që jetojnë në këtë vend.

Në rast se vota e emigrantëve do të bëhet realitet sipas propozimit aktual, mbetet për t’u parë se sa do të jenë të interesuar emigrantët, apo sa të lehtë do t’ua bëjë procesin KQZ dhe Rregullatori për të votuar dhe se çfarë pasojash do të ketë në rezultatet zgjedhore dhe në qeverisjen e vendit./BIRN

George – prej kohësh i urryer nga mbështetësit e Orbánit dhe Trumpit, si agjent i liberalizmit shkatërrimtar. Mos asgjë, Vuçiçi është i ngjashëm me Orbánin, sugjerojnë analistët. Teksa Vuçiçi është jehonë e Orbánit, “nuk është kopje e zakonshme”, thotë avokati Antonijeviq, i cili shprehet se, për shembull, mediat në Serbi janë më pak të kontrolluara se në Hungari. Administrata Biden ka investuar kohë dhe para për ta sjell Vuçiçin në kampin e Perëndimit dhe e ka mbështetur një projekt ambicioz të energjisë diellore në Serbi. Megjithatë, nuk ka dyshim se Trumpi do të ishte partner më i natyreshëm se Bideni. “Ai beson se nëse Trumpi fiton, do të jetë mirë për të”, thotë një diplomat evropian. “Grenelli ka qenë shumë aktiv në rajon në katër vitet e fundit, në anën e Beogradit”.

Kur u pyet se si një mandat i dytë i Trumpit mund të ndikojë në Serbi, Vuçiçi i mbron qëllimet e veta. “Nuk jam lider aq i madh sa shumë të tjerë në Evropë që marrin anë”, thotë ai. “Miku im Viktor [Orbán] është 100 përqind në anën e Trumpit. Miqtë e mi nga Brukseli janë 100 përqind në anën e Bidenit. Unë nuk jam. Unë jam në anën serbe, në pritje të rezultatëve”.

Por, ai vazhdon të kujtojë një vizitë në Shtëpinë e Bardhë të Trumpit – dhe ta krahasojë atë me takimet e

përkohshme me Bidenin. “Kur e vizitova Shtëpinë e Bardhë, kjo ishte në një kohë të mosmarrëveshjeve të mëdha me Rick Grenellin, por ai ishte person shumë i zellshëm, shumë i përkushtuar. Patëm gati tri orë diskutime në një dhomë të ngjashme me nëndetëse. Nuk mund të them se tani e kam të njëjtin trajtim. Por, mund të them se pata një bisedë të mirë me Trumpin”. “Kam pasur biseda të mira me Bidenin para se të bëhej president. Pas kësaj e takova një herë, dy herë në pritje, për dy minuta, por jo në biseda thelbësore. Nëse e pyetni shumicën e serbëve, 90 përqind do të jenë në anën e Trumpit”.

Tashti, pyetja e madhe për rajonin është se si mund të ndikojë rizgjedhja e Trumpit në ndarjet e thella dhe të vazhdueshme midis fqinjëve më të afërt të Serbisë.

Në rrugën nga aeroporti që çon në Beograd, shkronjat e mëdha të zeza shtrihen mbi një mbikalim: “Kosova është Serbi”. Ana tjetër e mbikalimit, e dukshme për ata që largohen nga qyteti, thotë: “Mos harroni – Kosova është Serbi”.

Statusi i Kosovës, vendlindja e sajuar e kombit serb, ka qenë plagë politike në rajon që nga viti 1999, kur fushata bombarduese e NATO-s ia hapi rrugën ish-krahinës për të shpallur në

vitin 2008 pavarësinë nga Serbia.

Vitin e kaluar, negociatorët e BE-së ndërmjetësuan një marrëveshje tentative, të mbështetur nga administrata Biden, sipas së cilës Beogradi do të lejonte joformalisht Kosovën që të integrohej në organizatat ndërkombëtare, ndërsa Prishtina do të jepte autonomi më të madhe për rajonet me shumicë serbe. Por, marrëveshja nuk është zbatuar kurrë.

Intensiteti i negociatave mund të rritet në mënyrë dramatike nëse Trumpi rizgjedhet. Në diskutimet private, Grenelli ka sinjalizuar se nëse ai emërohet në një rol të lartë në një mandat të dytë të mundshëm të Trumpit, Ballkani do të ishte prioritet për të dhe se ai e sheh Serbinë dhe rajonin si aleat të natyreshëm të Amerikës.

Sipas diplomatëve në rajon, kur Grenelli ishte i dërguari për Ballkanin, ai e shtyu fort para marrëveshjen për Kosovën. E ndërpreu strategjinë e BE-së duke argumentuar për zgjidhje të shpejtë, duke zemëruar shumë zyrtarë evropianë dhe disa diplomatë të Departamentit të Shtetit për tonin e tij konfrontues.

Ai gjithashtu e bëri të qartë se ka pak kohë për qëndrimin e Albin Kurtit, të

kryeministrit të Kosovës. Vitin e kaluar, zyrtarët e BE-së dhe administrata e Bidenit gjithashtu janë frustuar me Kurtin, duke e akuzuar atë si të pakompromis dhe se po e minon shpresën për zgjidhje.

Zyrtarët kosovarë dhe kundërshtarët vendorë shqetësohen se një administratë e dytë e Trumpit do të ishte e butë ndaj Vuçiçit. Aleatët e Grenellit përgjigjen duke treguar se si ai, në të kaluarën, i ka bërë presion Vuçiçit për t’u larguar nga Moska dhe e kanë shtyrë atë të diversifikojë furnizimin me energji nga Rusia – nga shteti që siguron pjesën më të madhe të gazit të Serbisë.

Për Vuçiçin, shtytja e përsheptuar për një marrëveshje do të paraqiste një dilemë. Pranimi i pavarësisë së Kosovës është kusht formal për integrimin e Serbisë në BE. Megjithatë, të dorëzohesh ndaj presionit të Perëndimit dhe të pajtohesh me të, kjo mund të jetë vetëvrasje politike. “Askush nuk ka qenë aq popullor sa Vuçiçi në 30 vjetët e fundit”, thotë Bogosavleviq. “Por, edhe me këtë popullaritet, edhe sikur të donte të thërriste referendumin për pavarësinë e Kosovës, ai nuk do të mund ta kalonte atë”.

Duke u kthyer kah Kosova, Vuçiçi së

fundmi ka nxitur rritjen e ndjenjave nacionaliste në Bosnjë. Megjithatë, diplomatët perëndimorë thonë se e besojnë kur thotë se prioriteti i tij është zhvillimi ekonomik. Projekti i tij kryesor, i cili do të përkohet me përfundimin e planifikuar të presidencës së tij në vitin 2027, është Expo-ja, panairi botëror i cili shpreson se do ta vë Serbinë në një rrugë të re ekonomike. “Kur flas për Expo-n, flas për ndryshime thelbësore të këtij vendi”, thotë ai.

Në këtë kontekst, Vuçiçi sheh mundësi për investime, nga kushdo që fiton zgjedhjet në ShBA – duke bërë me dije për projektet e pasurive të paluajtshme në linjat e marrëveshjes Kushner/Grenell, si dhe për Ujoren e Beogradit – projektin në bregun e lumit Sava. Kjo u mbështet nga i njëjti zhvillues i Emirateve, Mohamed Alabbar, i cili qëndron prapa projektit Marina në Durrës në Shqipëri.

Për kundërshtarët e tij të dëshpëruar, llafet e tilla janë të kota. Ata e shohin Vuçiçin si dyfyturësh të cilit nuk i besohet. Vuçiçi shmang kritikën dhe thotë se të gjithë duhet të mësojnë të ndryshojnë. “Duhet të mësosh, për çdo ditë”, thotë ai. “Vetëm gomarët nuk ndryshojnë mendje”.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

**Ne mund t'iu
ndihmojme edhe me:**

Business Cards

Logos

Banners

Video Marketing

Adresa e zyrave

**30 Avenons Road
London E13 8HT**

Na kontaktoni



**020 7018 7929
073 4066 5946**

